Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit - Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

RREGULLORE (ZKM) –NR. 01/2020 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT[1]

REGULATION (OPM) – NO. 01/2020 ON INTERNAL ORGANIZATION AND SYSTEMATIZATION OF JOBS IN THE OFFICE OF THE PRIME MINISTER[2]

UREDBA (KP) –BR. 01/2020 O UNUTRAŠNJOJ ORGANIZACIJI I SISTEMATIZACIJI RADNIH MESTA U KANCELARIJI PREMIJERA[3]

[1] Rregullorja (ZKM) –Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit është miratuar nga Kryeministri, me Vendimin Nr. 251/2020, të datës 16.11.2020.
[2] Regulation (OPM) – No. 01/2020 on Internal Organization and Systematization of Jobs in the Office of the Prime Minister is approved by the Prime Minister, with th Decision No. 251/2020, date 16.11.2020.
[3] Uredba (KP) –Br. 01/2020 o Unutrašnjoj Organizaciji i Sistematizaciji Radnih Mesta u Kancelariji Premijera odobrio je premijer, Odlukom br. 251/2020, dana 16.11.2020.

Kryeministri i Republikës së Kosovës,	**Prime Minister of the Republic of Kosovo,**	**Premijer Republike Kosovo,**
Në mbështetje të nenit 94 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 (3) dhe 28 (3) të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, nr. 7, 1 mars 2019) dhe nenit 2 (2) dhe 9 (7) të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura,	Pursuant to Article 94 (3) of the Constitution of the Republic of Kosovo, Article 15 (3) and 28 (3) of the Law No. 06/L-113 on Organization and Functioning of State Administration and Independent Agencies (Official Gazette, No. 7, 1 March 2019) and Article 2 (2) and 9 (7) of the Regulation (GRK) No. 01/2020 on Standards for Internal Organization, Systematization of Jobs and Cooperation in State Administration Institutions and Independent Agencies,	Na osnovu člana 94. (3) Ustava Republike Kosovo, člana 15. (3) i 28. (3) Zakona br. 06/L-113 o organizaciji i funkcionisanju državne uprave i nezavisnih agencija (Službeni list, br. 7, od 1. marta 2019. godine) i člana 2. (2) i 9 (7) Uredbe (VRK) Br. 01/2020 o standardima unutrašnje organizacije, sistematizaciji radnih mesta i saradnji u institucijama državne uprave i nezavisnih agencija,
Nxjerr:	Issues:	Donosi:
RREGULLORE (ZKM) – NR. 01/2020 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT	**REGULATION (OPM) – NO. 01/2020 ON INTERNAL ORGANIZATION AND SYSTEMATIZATION OF JOBS IN THE OFFICE OF THE PRIME MINISTER**	**UREDBU (KP) – BR. 01/2020 O UNUTRAŠNJOJ ORGANIZACIJI I SISTEMATIZACIJI RADNIH MESTA U KANCELARIJI PREMIJERA**
KAPITULLI I **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**	**CHAPTER I** **GENERAL PROVISIONS**	**POGLAVLJE I** **OPŠTE ODREDBE**
Neni 1 **Qëllimi**	**Article 1** **Purpose**	**Član 1** **Cilj**

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Zyrën e Kryeministrit.	The purpose of this Regulation is to define the internal organization and systematization of jobs in the Office of Prime Minister.	Ova Uredba ima za cilj utvrđivanje unutrašnje organizacije i sistematizaciju radnih mesta u Kancelariji premijera.
Neni 2 **Fushëveprimi**	**Article 2** **Scope**	**Član 2** **Delokrug**
1. Kjo rregullore zbatohet për Zyrën e Kryeministrit.	1. This Regulation shall apply to the Office of the Prime Minister.	1. Ova uredba se primenjuje na Kancelariju premijera.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës së Kryeministrit (ZKM) janë të përcaktuara në rregulloren përkatëse të punës së Qeverisë, rregulloren përkatëse për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive si dhe në legjislacionin tjetër në fuqi.	2. Duties and responsibilities of the Office of the Prime Minister (OPM) are determined in the relevant Rules and Procedures of the Government, relevant Regulation on Areas of Administrative Responsibility of the Office of Prime Minister and Ministries and other legislation in force.	2. Dužnosti i odgovornosti Kancelarije premijera (KP-a) utvrđene su u relevantnom Pravilniku o radu vlade, relevantnoj Uredbi o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, i drugim važećim zakonodavstvom.
KAPITULLI II **ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMI I VENDEVE TË PUNËS NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT**	**CHAPTER II** **INTERNATIONAL ORGANIZATION AND SYSTEMATIZATION OF JOBS IN THE OFFICE OF THE PRIME MINISTER**	**POGLAVLJE II** **UNUTRAŠNJA ORGANIZACIJA I SISTEMATIZACIJA RADNIH MESTA U KANCELARIJI PREMIJERA**
Neni 3 **Struktura organizative e Zyrës së Kryeministrit**	**Article 3** **Organizational structure of the Office of the Prime Minister**	**Član 3** **Organizaciona struktura Kancelarije premijera**
1. Struktura organizative në Zyrën e Kryeministrit është si në vijim:	1. Organizational structure in the Office of the Prime Minister shall be as follows:	1. Organizaciona struktura Kancelarije premijera je sledeća:

1.1. Kabineti i Kryeministrit;	1.1. Cabinet of the Prime Minister;	1.1. Kabinet premijera;
1.2. Kabineti i Zëvendëskryeministrit;	1.2. Cabinet of the Deputy Prime Minister;	1.2. Kabinet zamenika premijera;
1.3. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm;	1.3. Office of the Secretary General;	1.3. Kancelarija Generalnog sekretara;
1.4. Zyrat;	1.4. Offices;	1.4. Kancelarije;
1.5. Divizionet;	1.5. Divisions;	1.5. Odseci;
1.6. Agjencitë ekzekutive; dhe	1.6. Executive Agencies; and	1.6. Izvršne agencije; i
1.7. Strukturat e tjera administrative që veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në bazë të ligjeve të veçanta;	1.7. Other administrative structures operating within the Office of the Prime Minister based on special laws;	1.7. Druge administrativne strukture koje deluju u okviru Kancelarije premijera na osnovu posebnih zakona;
2. Numri i nëpunësve civilë në ZKM është njëqind e nëntëdhjetë e pesë (195).	2. Number of civil servants in OPM shall be one hundred and ninety-five (195).	2. Broj državnih službenika u KP-u je sto devedeset pet (195).
Neni 4 **Kabineti i Kryeministrit**	**Article 4** **Cabinet of the Prime Minister**	**Član 4** **Kabinet premijera**
1. Kabineti i Kryeministrit përbëhet nga:	1. Cabinet of the Prime Minister shall be composed of:	1. Kabinet premijera čine:
1.1. Kryeministri;	1.1. Prime Minister;	1.1. Premijer;
1.2. Zëvendëskryeministrat;	1.2. Deputy Prime Ministers;	1.2. Zamenici premijera;
1.3. Këshilltarët politikë të	1.3. Political Advisors to the Prime	1.3. Politički savetnici premijera;

Kryeministrit; 1.4. Këshilltarët politikë të zëvendëskryeministrave, 1.5. Nëpunësit e punësuar në kabinetin e Kryeministrit; si dhe 1.6. Nëpunësit e punësuar në kabinetin e zëvendëskryeministrave. 2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryeministrit, zëvendëskryeministrave, këshilltarëve politikë si dhe të nëpunësve të punësuar në kabinet të Kryeministrit, përcaktohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligje të veçanta, rregulloren përkatëse të punës së Qeverisë, rregulloren përkatëse për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi. **Neni 5** **Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm** 1. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit përbëhet nga: 1.1. Sekretari i Përgjithshëm; dhe 1.2. Nëpunësit civilë profesional dhe	Minister; 1.4. Political Advisors to Deputy Prime Ministers, 1.5. Staff in the Cabinet of the Prime Minister; and 1.6. Staff in the Cabinet of Deputy Prime Ministers. 2. Duties and responsibilities of the Prime Minister, Deputy Prime Ministers, Political Advisors and staff in the Cabinet of the Prime Minister are determined in the Constitution of the Republic of Kosovo, special laws, relevant Rules of Procedures of the Government, relevant Regulation on Areas of Administrative Responsibility of the Office of Prime Minister and Ministries, as well as other legislation in force. **Article 5** **Office of the Secretary General** 1. Office of the Secretary General within the Office of the Prime Minister shall be composed of: 1.1. Secretary General; and 1.2. Professional and supporting civil	1.4. Politički savetnici zamenika premijera, 1.5. Službenici zaposleni u kabinetu premijera; i 1.6. Službenici zaposleni u kabinetu zamenika premijera. 2. Dužnosti i odgovornosti premijera, zamenika premijera, političkih savetnika i službenika zaposlenih u Kabinetu premijera, utvrđene su Ustavom Republike Kosovo, posebnim zakonima, relevantnim Pravilnikom o radu Vlade, relevantnom Uredbom o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, kao i drugim važećim zakonodavstvom. **Član 5** **Kancelarija Generalnog sekretara** 1. Kancelariju Generalnog sekretara u Kancelariji premijera čine: 1.1. Generalni sekretar, i 1.2. Stručni i pomoćni državni

mbështetës.	servants.	službenici.
2. Nëpunësit civilë profesional dhe mbështetës në kuadër të Zyrës së Sekretarit janë:	2. Professional and supporting civil servants within the Office of the Secretary shall be:	2. Stručni i pomoćni državni službenici u Kancelariji sekretara su:
2.1. Zyrtari i lartë ekzekutiv;	2.1. Senior Executive Officer;	2.1. Viši izvršni službenik;
2.2. Zyrtari ekzekutiv; dhe	2.2. Executive Officer; and	2.2. Izvršni službenik; i
2.3. Zyrtari administrativ.	2.3. Administrative Officer.	2.3. Administrativni službenik.
3. Pozitat e tjera që i përgjigjen drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm:	3. Other positions that directly respond to the Secretary General:	3. Drugi pozicije koje direktno odgovaraju Generalnom sekretaru:
3.1. Zyrtari i lartë certifikues.	3.1. Senior Certifying Officer.	3.1. Viši službenik za overu.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm përcaktohen me ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, ligjit përkatës për zyrtarët publikë, rregulloren përkatëse për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.	4. Duties and responsibilities of the Secretary General are determined in the relevant law for organization and functioning of state administration and independent agencies, relevant law for public officials, relevant law for areas of administrative responsibility of the Office of Prime Minister and Ministries, as well as other legislation in force.	4. Dužnosti i odgovornosti Generalnog sekretara utvrđene su relevantnim Zakonom o organizaciji i opštem funkcionisanju državne uprave i nezavisnih agencija, relevantnim Zakonom o javnim službenicima, relevantnom Uredbom o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, i drugim važećim zakonodavstvom.
5. Detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësve civilë dhe mbështetës përcaktohen në ligjin përkatës për zyrtarët publikë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.	5. Duties and responsibilities of professional and supporting civil servants shall be determined in the relevant law for public officials and other legislation in force.	5. Dužnosti i odgovornosti državnih i pomoćnih službenika utvrđene su relevantnim Zakonom o javnim službenicima i drugim važećim zakonodavstvom.

6. Numri i të punësuarve në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm është pesë (5).	6. Number of employees in the Office of the Secretary General shall be five (5).	6. Broj zaposlenih u Kancelariji generalnog sekretare je pet (5).
Neni 6 **Zyrat dhe divizionet në kuadër të Zyrës së Kryeministrit**	**Article 6** **Offices and divisions within the Office of the Prime Minister**	**Član 6** **Kancelarije i odseci u okviru Kancelarije premijera**
1. Zyrat dhe divizionet në kuadër të Zyrës së Kryeministrit janë:	1. Offices and divisions within the Office of the Prime Minister shall be:	1. Kancelarije i odseci u okviru Kancelarije premijera su::
1.1. Zyra Ligjore (ZL):	1.1. Legal Office (LO):	1.2. Pravna kancelarija (PK):
1.1.1. Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit;	1.1.1. Division for Drafting and Harmonization of Legislation;	1.1.1. Odsek za izradu i usklađivanje zakonodavstva;
1.1.2. Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit;	1.1.2. Division for Monitoring the Implementation of Legislation, Legal Support and Interinstitutional Cooperation in the Field of Legislation;	1.1.2. Odsek za nadgledanje sprovođenja zakonodavstva, pravnu podršku i međuinstitucionalnu saradnju u oblasti zakonodavstva;
1.1.3. Divizioni për Zvogëlimin e Barrës Administrative nëpërmjet Thjeshtimit të Lejeve dhe Licencave;	1.1.3. Division for Reduction of Administrative Burden by Simplifying Permits and Licences;	1.1.3. Odsek za smanjenje administrativnog opterećenja pojednostavljenjem dozvola i licenci;
1.1.4. Divizioni për të Drejtën e BE-së.	1.1.4. Division for EU Law.	1.1.4. Odsek za zakonodavstvo EU-a.
1.2. Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS):	1.2. Strategic Planning Office (SPO):	1.2. Kancelarija za strateško planiranje (KSP):

1.2.1. Divizioni për Planifikim;	1.2.1. Division for Planning;	1.2.1. Sektor za planiranje;
1.2.2. Divizioni për Monitorim dhe Vlerësim;	1.2.2. Division for Monitoring and Evaluation;	1.2.2. Sektor za praćenje i procenu;
1.2.3. Divizioni për Analiza të Politikave.	1.2.3. Division for Policy Analyses.	1.2.3. Odsek za analize politika.
1.3. Sekretariati Mbështetës i Qeverisë (SMQ):	1.3. Government Supporting Secretariat (GSS):	1.3. Sekretarijat podrške Vladi (SPV):
1.3.1. Divizioni për Mbledhje të Qeverisë dhe Koordinim me Kuvendin;	1.3.1. Division for Organization of Government Meetings and Coordination with the Assembly;	1.3.1. Odsek za vladine vlade i koordinaciju sa Skupštinom;
1.3.2. Divizioni për Mbështetje të Komisioneve për Rekrutimin e Drejtorëve të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike.	1.3.2. Division for Supporting Commissions for Recruitment of Directors of Publicly-Owned Enterprises.	1.3.2. Odsek za podršku komisijama za regrutovanje direktora odbora javnih preduzeća.
1.4. Zyra për Qeverisje të Mirë dhe të Drejtat e Njeriut (ZQMDNJ):	1.4. Office for Good Governance and Human Rights (OGGHR):	1.4. Kancelarija za dobro upravljanje i ljudska prava (KDULJP):
1.4.1. Divizioni për Qeverisje të Mirë;	1.4.1. Division for Good Governance;	1.4.1. Odsek za dobro upravljanje;
1.4.2. Divizioni për të Drejtat e Njeriut.	1.4.2. Division for Human Rights.	1.4.2. Odsek za ljudska prava.
1.5. Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare (ZPGZ):	1.5. Office for Publication of Official Gazette (OPOG):	1.5. Kancelarija za objavljivanje Službenog lista (KOSL):

1.5.1. Divizioni për Pranim, Korrektim dhe Redaktim Teknik të Gazetës Zyrtare;	1.5.1. Division for Receiving, Correcting and Technical Editing of the Official Gazette;	1.5.1. Odsek za prijem, korekturu i tehničko uređivanje Službenog lista;
1.5.2. Divizioni për Botim, Publikim dhe Mirëmbajtje të Sistemit Elektronik të Gazetës Zyrtare;	1.5.2. Division for Issuance, Publication and Maintenance of Official Gazette Electronic System;	1.5.2. Odsek za izdavanje, objavljivanje i održavanje elektronskog sistema Službenog lista;
1.5.3. Divizioni për Konsolidimin e Akteve Juridike.	1.5.3. Division for Consolidation of Legal Acts.	1.5.3. Odsek za konsolidaciju pravnih akata.
1.6. Zyra për Koordinimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (ZKPSA):	1.6. Office for Coordination of Stabilisation and Association Process (OCSAP):	1.6. Kancelarija za koordinaciju procesa stabilizacije i pridruživanja (KKPSP):
1.6.1. Divizioni për Koordinim Horizontal të Procesit të Stabilizim-Asociimit;	1.6.1. Division for Horizontal Coordination of the Stabilisation and Association Process;	1.6.1. Odsek za horizontalnu koordinacija procesa stabilizacije i pridruživanja;
1.6.2. Divizioni për Koordinim Institucional.	1.6.2. Division for Institutional Coordination.	1.6.2. Odsek za institucionalnu koordinaciju.
1.7. Zyra për Kriteret Politike (ZKP):	1.7. Office for Political Criteria (OPC):	1.7. Kancelarija za političke kriterijume (KPK):
1.7.1. Divizioni për Kriteret Politike dhe Administrative;	1.7.1. Division for Political and Administrative Criteria;	1.7.1. Odsek za političke i administrativne kriterijume;
1.7.2. Divizioni për Gjyqësorin dhe të Drejtat Themelore;	1.7.2. Division for Judiciary and Fundamental Rights;	1.7.2. Odsek za pravosuđe i osnovna prava;
1.7.3. Divizioni për Drejtësi, Liri	1.7.3. Division for Justice,	1.7.3. Odsek za pravdu, slobodu i

dhe Siguri.	Freedom and Security.	bezbednost.
1.8. Zyra për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm (ZKETB):	1.8. Office for Economic Criteria and Internal Market (OECIM):	1.8. Kancelarija za ekonomske kriterijume i unutrašnje tržište (KEKUT):
1.8.1. Divizioni për Ekonomi, Zhvillim Rajonal dhe Statistika;	1.8.1. Division for Economy, Regional Development and Statistics;	1.8.1. Odsek za ekonomiju, regionalni razvoj i statistike;
1.8.2. Divizioni për Tregun e Brendshëm dhe Tregtinë;	1.8.2. Division for Internal Market and Trade;	1.8.2. Odsek za unutrašnje tržište i trgovinu;
1.8.3. Divizioni për Politika Sociale, Arsim dhe Shëndetësi.	1.8.3. Division for Social Policies, Education and Health.	1.8.3. Odsek za socijalnu politiku, obrazovanje i zdravstvo.
1.9. Zyra për Politikat Sektoriale (ZPoS):	1.9. Office for Sector Policies (OSP):	1.9. Kancelarija za sektorske politike (KSP):
1.9.1. Divizioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Siguri të Ushqimit;	1.9.1. Division for Agriculture, Forestry, Rural Development and Food Safety;	1.9.1. Odsek za poljoprivredu, šumarstvo, ruralni razvoj i bezbednost hrane;
1.9.2. Divizioni për Mjedis, Energji dhe Transport.	1.9.2. Division for Environment, Energy and Transport.	1.9.2. Odsek za životnu sredinu, energiju i transport.
1.10. Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim (ZBZH):	1.10. Development Cooperation Office (DCO):	1.10. Kancelarija saradnje za razvoj (KSR):
1.10.1. Divizioni për Monitorim dhe Raportim;	1.10.1. Division for Monitoring and Reporting;	1.10.1. Odsek za praćenje i izveštavanje;
1.10.2. Divizioni për	1.10.2. Division for Public	1.10.2. Odsek za javnu upravu i

Administratën Publike dhe Sundimin e Ligjit;	Administration and Rule of Law;	vladavinu prava;
1.10.3. Divizioni për Zhvillim Ekonomik dhe Social.	1.10.3. Division for Economic and Social Development.	1.10.3. Odsek za ekonomski i socijalni razvoj.
1.11. Zyra për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (ZÇKDLUÇK):	1.11. Office for Issues of Categories Deriving from the War of the Kosovo Liberation Army (OICDW of KLA):	1.11. Kancelarija za pitanja kategorija proizišlih iz rata Oslobodilačke vojske Kosova (KPKPROVK):
1.11.1. Divizioni për Veteranët e Luftës së UÇK-së;	1.11.1. Division for KLA War Veterans;	1.11.1. Odsek za ratne veterane OVK-a;
1.11.2. Divizioni për Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidët e Luftës së UÇK-së.	1.11.2. Division for Families of Martyrs and KLA War Invalids.	1.11.2. Odsek za porodice palih boraca i ratne invalide OVK-a.
1.12. Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK):	1.12. Office for Community Affairs (OCA):	1.12. Kancelarija za pitanja zajednica (KPZ):
1.12.1. Divizioni për Politika të Komuniteteve;	1.12.1. Division for Community Policies;	1.12.1. Odsek za politiku zajednica;
1.12.2. Divizioni për Koordinim dhe Monitorim të Granteve dhe Subvencioneve.	1.12.2. Division for Coordination and Monitoring of Grants and Subsidies.	1.12.2. Odsek za koordinaciju i nadgledanje garantova i subvencija.
1.13. Zyra për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme (ZASHP):	1.13. Office for Administration and General Services (OAGS):	1.13. Kancelarija za opštu upravu i usluge (KOUU):
1.13.1. Divizioni për Teknologji Informative;	1.13.1. Division for Information Technology;	1.13.1. Odsek za informacionu tehnologiju;

1.13.2. Divizioni për Përkthime;	1.13.2. Division for Translation;	1.13.2. Odsek za prevođenje;
1.13.3. Divizioni për Logjistikë;	1.13.3. Division for Logistics;	1.13.3. Odsek za logistiku;
1.13.4. Divizioni për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv.	1.13.4. Division for Administration of Documents and Archive.	1.13.4. Odsek za administraciju dokumenata i arhivu.
1.14. Zyra për Buxhet dhe Financa (ZBF):	1.14. Office for Budget and Finance (OBF):	1.14. Kancelarija za budžet i finansije (KBF):
1.14.1. Divizioni për Buxhet;	1.14.1. Division for Budget;	1.14.1. Odsek za budžet;
1.14.2. Divizioni për Financa.	1.14.2. Division for Finances.	1.14.2. Odsek za finansije.
1.15. Divizioni për Prokurim Publik (DPP);	1.15. Division for Public Procurement (DPP);	1.15. Odsek za javne nabavke (OJN);
1.16. Divizioni për Komunikim dhe Informim (DKI);	1.16. Division for Communication and Information (DCI);	1.16. Odsek za komunikaciju i informacije (OKI);
1.17. Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (DMBNJ);	1.17. Division for Human Resource Management (DHRM);	1.17. Odsek za upravljanje ljudskim resursima (OULJR);
1.18. Njësia për Auditim të Brendshëm (NJAB);	1.18. Internal Audit Unit (IAU);	1.18. Jedinica za internu reviziju (JIR);
1.19. Zyra e ish-Kryeministrit.	1.19. Office of the Former Prime Minister.	1.19. Kancelarija bivšeg premijera.

Neni 7 Organizimi i Zyrave	Article 7 Organization of Offices	Član 7 Organizacija kancelarija
1. Zyrat në kuadër të ZKM-së kanë statusin e departamentit në kuptim të ligjit përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura.	1. Offices within OPM shall have the status of department pursuant to the relevant law for organization and functioning of state administration and independent agencies.	1. Kancelarije u okviru KP-a imaju status odeljenja u smislu relevantnog Zakona o organizaciji i funkcionisanju državne uprave i nezavisnih agencija.
2. Zyrat udhëhiqen nga drejtorët e zyrave.	2. Offices shall be led by directors of offices.	2. Kancelarije vode direktori kancelarija.
3. Zyrat janë të ndara në divizione, të cilat udhëhiqen nga udhëheqësit e divizioneve.	3. Offices shall be divided into divisions, which shall be led by Heads of Divisions.	3. Kancelarije su podeljene u odseke koje vode rukovodioci odseka.
Neni 8 **Zyra Ligjore**	**Article 8** **Legal Office**	**Član 8** **Pravna kancelarija**
1. Zyra Ligjore (ZL) është njësi organizative në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, që ka për mision të ofrojë mbështetje juridike për punën e Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë, të koordinojë punën e ministrive në procesin e zhvillimit dhe përmirësimit të kornizës ligjore në Kosovë, si dhe të sigurojë harmonizimin me Kushtetutë, legjislacionin në fuqi, *Acquis* dhe me standardet ndërkombëtare.	1. The Legal Office (LO) is an organizational unit within the Office of the Prime Minister, with the mission to provide legal support to the work of the Office of the Prime Minister and Government, coordinate the work of ministries in the development process and improve the legal framework in Kosovo, as well as to ensure harmonization with the Constituton, legislation in force, *Acquis* and international standards.	1. Pravna kancelarija (PK) je organizaciona jedinica u okviru Kancelarije premijera koja ima misiju da pruža pravnu podršku radu Kancelarije premijera i Vlade, da koordinira rad ministarstava u procesu razvoja i unapređenja zakonskog okvira na Kosovu, kao i da osigura usklađenost sa Ustavom, važećim zakonodavstvom, pravnom tekovinom EU i međunarodnim standardima.
2. Zyra Ligjore ka detyrat dhe përgjegjësitë, si në vijim:	2. The Legal Office has the following duties and responsibilities:	2. Pravna kancelarija ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

2.1. Përgatitja e propozimeve të projekt amendamenteve kushtetuese, projekt marrëveshjeve ndërkombëtare që nënshkruhen nga Kryeministri, projektligjeve, projekt akteve nënligjore dhe projekt akteve të tjera juridike nga fushëveprimi i ZKM-së;	2.1. Preparing proposals for draft constitutional amendments, draft international agreements signed by the Prime Minister, draft laws, draft sub-legal acts and other draft legal acts from the scope of OPM;	2.1. Priprema predloga za nacrt ustavnih amandmana, nacrta međunarodnih sporazuma koje potpisuje premijer, nacrta zakona, nacrta podzakonskih akata i drugih nacrta pravnih akata iz delokruga KP-a;
2.2. Bashkërendimi i procesit të përgatitjes së Programit Legjislativ të Qeverisë, Planit Legjislativ për Aktet Nënligjore dhe Programit për Vlerësimin Ex-Post të Legjislacionit, si dhe përditësimi dhe monitorimi i zbatimit të tyre;	2.2. Coordination of the process for preparing the Government Legislative Program, Legislative Plan for Sub-legal Acts and Program for Ex-Post Assessment of Legislation, as well as updating and monitoring of their implementation;	2.2. Koordinacija procesa pripreme Zakonodavnog programa Vlade, Zakonodavnog plana za podzakonske akte i Programa za Ex-Post procenu zakonodavstva, kao i ažuriranje i praćenje njihovog sprovođenja;
2.3. Bashkërendimi me ministritë në procesin e hartimit të projektligjeve, projekt akteve nënligjore dhe projekt akteve tjera juridike, shqyrtimi i konsistencës së tyre me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, si dhe kontrollimi i cilësisë së tyre me standardet e hartimit të legjislacionit;	2.3. Coordination with ministries in the process for developing draft laws, draft sub-legal acts and other draft legal acts, reviewing their consistency with the Constitution and legislation in force, as well as checking their quality against legislation drafting standards;	2.3. Koordinacija sa ministarstvima u procesu izrade nacrta zakona, nacrta podzakonskih akata i drugih nacrta pravnih akata, preispitivanje njihove usklađenosti sa Ustavom i važećim zakonodavstvom, kao i kontrola njihovog kvaliteta sa standardima izrade zakonodavstva;
2.4. Shqyrtimi i versioneve përfundimtare të projekt-akteve juridike, të cilat procedohen për shqyrtim dhe miratim në mbledhje të Qeverisë të propozuara nga ministritë dhe organet tjera propozuese nëse janë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, *Acquis* dhe	2.4. Reviewing whether final versions of draft legal acts, which are proceeded for review and adoption in the Government meetings, as proposed by ministries and other proposing bodies, comply with the Constitution, legislation in force, *Acquis* and drafting standards;	2.4. Razmatranje konačnih verzija nacrta pravnih akata, koji se prosleđuju za razmatranje i usvajanje na sednicama Vlade, koje predlažu ministarstva i drugi organi predlagači, da li su u skladu sa Ustavom, važećim zakonodavstvom, *Acquis* i standardima za izradu;

standardet e hartimit;		
2.5. Bashkërendimi me ministritë në procesin e përgatitjes së opinioneve të Qeverisë për nismat ligjore të Kuvendit;	2.5. Coordination with ministries in the process for preparing opinions of the Government for legal initiatives of the Assembly;	2.5. Koordinacija sa ministarstvima u procesu pripreme mišljenja Vlade o zakonskim inicijativama Skupštine;
2.6. Bashkërendimi me ministritë sa i përket parashtrimit të kërkesave për opinion ligjor në Komisionin e Venedikut dhe sigurimi i zbatimit të rekomandimeve të Komisionit të Venedikut në projekt-aktet juridike;	2.6. Coordination with ministries with regards to the submission of requests for Legal Opinion to the Venice Commission and ensuring implementation of Venice Commission recommendations in draft legal acts;	2.6. Koordinacija sa ministarstvima u pogledu podnošenja zahteva za pravno mišljenje Venecijanskoj komisiji i obezbeđivanje sprovođenja preporuka Venecijanske komisije u nacrtima pravnih akata;
2.7. Bashkërendimi me ministritë në procesin e Vlerësimit Ex-Post të Legjislacionit, hartimi dhe përditësimi i Udhërrëfyesit për Vlerësimin Ex-Post të Legjislacionit bazuar në praktikat më të mira;	2.7. Coordination with ministries in the process of Ex-Post Assessment of Legislation, developing and updating the Roadmap for Ex-Post Assessment of Legislation based on best practices;	2.7. Koordinacija sa ministarstvima u procesu Ex-post procene zakonodavstva, izrada i ažuriranje Vodiča za Ex-post procenu zakonodavstva na osnovu najboljih praksi;
2.8. Kryesimi dhe bashkërendimi i punës me Këshillin e Drejtorëve të Departamenteve Ligjore të Qeverisë e Republikës së Kosovës dhe Grupin Mbikëqyrës për Vlerësimin Ex-Post të Legjislacionit;	2.8. Chairing and coordinating the work with the Council of Directors of Legal Departments of the Government of the Republic of Kosovo and Monitoring Group for Ex-Post Assessment of Legislation;	2.8. Predsedavanje i koordinacija rada sa Savetom direktora pravnih odeljenja Vlade Republike Kosovo i Nadzornom grupom za Ex-Post procenu zakonodavstva;
2.9. Ofrimi i shërbimeve këshillimore, opinioneve, sqarimeve dhe ekspertizës juridike për Zyrën e Kryeministrit dhe Qeverinë;	2.9. Providing advisory services, opinions, explanations and legal expertise for the Office of the Prime Minister and Government;	2.9. Pružanje savetodavnih usluga, mišljenja, objašnjenja i pravne ekspertize za Kancelariju premijera i Vladu;

2.10. Shqyrtimi dhe pjesëmarrja në hartimin e koncept dokumenteve dhe dokumenteve strategjike për të siguruar që rekomandimet në to janë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi si dhe për të siguruar nëse është identifikuar nevoja për miratimin e ligjeve apo akteve nënligjore të nevojshme;	2.10. Review of, and participation in, drafting the concept documents and strategic documents to ensure that recommendations therein comply with the Constitution and legislation in force, as well as to ensure that the need for adoption of necessary laws or sub-legal acts has been identified;	2.10. Razmatranje i učešće u izradi koncept dokumenata i strateških dokumenata kako bi se obezbedilo da su preporuke u njima u skladu sa Ustavom i važećim zakonodavstvom, i kako bi se obezbedilo da je identifikovana potreba za usvajanjem potrebnih zakona ili podzakonskih akata;
2.11. Mbajtja dhe përditësimi i Regjistrit të të gjitha akteve nënligjore të miratuara nga Qeveria dhe ministritë;	2.11. Keeping and updating the register of all sub-legal acts adopted by the Government and ministries;	2.11. Vođenje i ažuriranje Registra svih podzakonskih akata koje je usvojila Vlada i ministarstva;
2.12. Mbajtja dhe përditësimi i Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave që lëshohen nga institucionet qendrore në Republikën e Kosovës;	2.12. Keeping and updating the Central Registry of Permits and Licences issued by central institutions in the Republic of Kosovo;	2.12. Vođenje i ažuriranje Centralnog registra dozvola i licenci koje izdaju centralne institucije u Republici Kosovo;
2.13. Sigurimi i përmbushjes së objektivave që dalin nga procesi i rregullimit më të mirë në zvogëlimin e barrës administrative gjatë procesit të hartimit të legjislacionit si dhe sigurimi i përfshirjes së propozimeve të tilla në Programin Legjislativ dhe Planin e Akteve Nënligjore;	2.13. Ensuring the fulfilment of objectives deriving from the better regulation process in reducing the administrative burden throughout the legislation drafting process, as well as ensuring the inclusion of such proposals in the Legislative Program and Plan of Bylaws;	2.13. Obezbeđivanje ispunjenja ciljeva koji proizilaze iz bolji proces prilagođavanja u smanjenju administrativnog opterećenja tokom procesa izrade zakonodavstva i obezbeđivanje uključivanja takvih predloga u Zakonodavni program i Planu podzakonskih akata;
2.14. Bashkërendimi dhe mbështetja e ministrive në zhvillimin e propozimeve për thjeshtimin e lejeve dhe licencave duke u bazuar në analiza, si dhe shqyrton projekt-aktet juridike që	2.14. Coordination and supporting of ministries in developing proposals for simplifying permits and licences based on analyses, as well as reviewing draft legal acts aiming the reduction of	2.14. Koordinacija i podrška ministarstvima u izradi predloga za pojednostavljenje dozvola i licenci na osnovu analiza, kao i razmatranje nacrta pravnih akata čiji je cilj smanjenje

synojnë uljen e barrëve administrative duke thjeshtuar lejet dhe licencat;	administrative burdens by simplifying permits and licences;	administrativnog opterećenja pojednostavljivanjem dozvola i licenci;
2.15. Sigurimi i integrimit të zvogëlimit të barrës administrative në procesin e vlerësimit ex post të legjislacionit;	2.15. Ensuring integration of administrative burden reduction in the process of Ex-Post Assessment of legislation;	2.15. Obezbeđivanje integracije smanjenja administrativnog opterećenja u proces ex-post procene zakonodavstva;
2.16. Ofrimi i opinioneve të vlerësimit të pajtueshmërisë së legjislacionit vendor me *Acquis*;	2.16. Providing opinions on assessment of compliance of national legislation with *Acquis*;	2.16. Davanje mišljenja o proceni usklađenosti domaćeg zakonodavstva sa *Acquis*-om;
2.17. Ofrimi i mbështetjes për përgatitjen e metodologjisë, planifikimit dhe hartimit të versionit kombëtar të *Acquis*;	2.17. Providing support for preparing the methodology planning and drafting the national version of *Acquis*;	2.17. Pružanje podrške pripremi metodologije, planiranja i izradi nacionalne verzije *Acquis*-a;
2.18. Ofrimi i mbështetjes për procesin e përkthimit dhe zhvillimin dhe zbatimin e metodologjisë së përbashkët te përkthimit;	2.18. Providing support for translation process and developing and implementing the joint translation methodology;	2.18. Pružanje podrške procesu prevođenja i razvoju i sprovođenju zajedničke metodologije prevođenja;
2.19. Ofrimi i mbështetjes për zhvillimin institucional të procesit të përafrimit, përfshirë ngritjen e kapaciteteve të institucioneve.	2.19. Providing support for institutional development of approximation process, including institutional capacity building.	2.19. Pružanje podrške institucionalnom razvoju procesa usklađivanja, uključujući izgradnju institucionalnih kapaciteta.
3. Zyra Ligjore kryen edhe detyrat dhe përgjegjësitë tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe detyrat e përcaktuara nga Kryeministri dhe Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së.	3. The Legal Office carries out other duties and responsibilities as set out in the legislation in force and duties assigned by the Prime Minister and Secretary General of OPM.	3. Pravna kancelarija obavlja i druge dužnosti i odgovornosti utvrđene važećim zakonodavstvom, kao i dužnosti utvrđene od strane Premijera i Generalnog Sekretara KP-a.

4. Drejtori i Zyrës Ligjore i raporton dhe i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit.	4. Director of Legal Office shall report and respond to the Secretary General within the Office of the Prime Minister.	4. Direktor Pravne kancelarije izveštava i odgovara Generalnom sekretaru u Kancelariji premijera.
5. Në kuadër të Zyrës Ligjore bëjnë pjesë divizionet si në vijim:	5. Legal Office is composed of five divisions, as follows:	5. U okviru Pravne kancelarije spadaju sledeći odseci:
5.1. Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit;	5.1. Division for Drafting and Harmonization of Legislation;	5.1. Odsek za izradu i usklađivanje zakonodavstva;
5.2. Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit;	5.2. Division for Monitoring the Implementation of Legislation, Legal Support and Interinstitutional Cooperation in the Field of Legislation;	5.2. Odsek za nadgledanje sprovođenja zakonodavstva, pravnu podršku i međuinstitucionalnu saradnju u oblasti zakonodavstva;
5.3. Divizioni për Zvogëlimin e Barrës Administrative nëpërmjet Thjeshtimit të Lejeve dhe Licencave;	5.3. Division for Administrative Burden Reduction by Simplifying Permits and Licences;	5.3. Odsek za smanjenje administrativnog opterećenja pojednostavljenjem dozvola i licenci;
5.4. Divizioni për Harmonizimin e Legjislacionit me *Acquis*.	5.4. Division for Harmonization of Legislation with *Acquis*.	5.4. Odsek za usklađivanje zakonodavstva sa *Acquis*-om.
6. Numri i të punësuarve në Zyrën Ligjore është njëzetedy (22).	6. The number of employees in the Legal Office is twenty-two (22).	6. Broj zaposlenih u Pravnoj kancelariji je dvadesetdva (22).
Neni 9 **Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit**	**Article 9** **Division for Drafting and Harmonization of Legislation**	**Član 9** **Odsek za izradu i usklađivanje zakonodavstva**
1. Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:	1. The Division for Drafting and Harmonization of Legislation has the following duties and responsibilities:	1. Odsek za izradu i usklađivanje zakonodavstva ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

1.1. Përgatitja e propozimeve të projekt amendamenteve kushtetuese, projekt marrëveshjeve ndërkombëtare që nënshkruhen nga Kryeministri, projektligjeve, projekt akteve nënligjore dhe projekt akteve të tjera juridike nga fushëveprimi i ZKM-së;	1.1. Preparing proposals for draft constitutional amendments, draft international agreements signed by the Prime Minister, draft laws, draft sub-legal acts and other draft legal acts from the scope of OPM;	1.1. Priprema predloga nacrta ustavnih amandmana, nacrta međunarodnih sporazuma koje potpisuje premijer, nacrta podzakonskih akata i nacrta drugih pravnih akata iz delokruga KP-a;
1.2. Bashkërendimi i punës së ministrive në procesin e hartimit të projektligjeve, projekt akteve nënligjore dhe projekt akteve tjera juridike, shqyrton konsistencën e tij me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, si dhe kontrollon cilësinë e tyre me standardet e hartimit të legjislacionit;	1.2. Coordination of the work of ministries in the process of developing draft laws, draft sub-legal acts and other draft legal acts, reviewing its consistency with the Constitution and legislation in force, as well as checking their quality against legislation drafting standards;	1.2. Koordinacija rada ministarstava u procesu izrade nacrta zakona, nacrta podzakonskih akata i nacrta drugih pravnih akata, preispituje njihovu usklađenost sa Ustavom i važećim zakonodavstvom, kao i kontroliše njihov kvalitet sa standardima izrade zakonodavstva;
1.3. Bashkërendimi në procesin e përgatitjes së opinioneve të Qeverisë për nismat ligjore të Kuvendit;	1.3. Coordination in the process of preparing opinions of the Government for legal initiatives of the Assembly;	1.3. Koordinacija u procesu pripreme mišljenja Vlade o zakonskim inicijativama Skupštine;
1.4. Bashkërendimi i punës me Këshillin e Drejtorëve të Departamenteve Ligjore;	1.4. Coordination of the work with the Council of Directors of Legal Departments;	1.4 Koordinacija rada sa Savetom direktora pravnih odeljenja;
1.5 Bashkërendimi i procesit të përgatitjes së Programit Legjislativ të Qeverisë dhe Planit Legjislativ për Aktet Nënligjore si dhe përditësimi dhe monitorimi i zbatimit të tyre;	1.5 Coordination of the process for preparing the Government Legislative Program and Legislative Plan for Bylaws, as well as updating and monitoring their implementation;	1.5 Koordinacija procesa pripreme Zakonodavnog programa i Zakonodavnog plana za podzakonske akte kao i ažuriranje i praćenje njihovog sprovođenja;
1.6. Ofrimi i ndihmës dhe	1.6. Providing assistance and	1.6. Pružanje podrške i koordinacija sa

bashkërendimi me Divizionin për të Drejtën e BE-së në procesin e përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Kosovës me *Acquis*;	coordination with the Division for EU Law in the process of compliance of the legislation of the Republic of Kosovo with *Acquis*;	Odsekom za usklađivanje zakonodavstva sa *Acquis*-om u procesu usklađivanja zakonodavstva Republike Kosovo sa *Acquis*;
1.7. Bashkërendimi me ministritë për parashtrimin e kërkesave për opinione ligjore në Komisionin e Venedikut.	1.7. Coordination with ministries for submission of requests for legal opinions to Venice Commission.	1.7. Koordinacija sa ministarstvima u pogledu podnošenja zahteva za pravno mišljenje Venecijanskoj komisiji.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit raporton te Drejtori i Zyrës.	2. Head of Division for Drafting and Harmonization of Legislation shall report to the Director of Office.	2. Rukovodilac Odseka za izradu i usklađivanje zakonodavstva izveštava direktoru Kancelarije.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit është nëntë (9).	3. Number of employees in the Division for Drafting and Harmonization of Legislation shall be nine (9).	3. Broj zaposlenih u Odseku za izradu i usklađivanje zakonodavstva je devet (9).
Neni 10 **Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit**	**Article 10** **Division for Monitoring the Implementation of Legislation, Legal Support and Interinstitutional Cooperation in the Field of Legislation**	**Član 10** **Odsek za nadgledanje sprovođenja zakonodavstva, pravnu podršku i međuinstitucionalnu saradnju u oblasti zakonodavstva**
1. Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:	1. The Division for Monitoring the Implementation of Legislation, Legal Support and Interinstitutional Cooperation in the Field of Legislation has the following duties and responsibilities:	1. Odsek za nadgledanje sprovođenja zakonodavstva, pravnu podršku i međuinstitucionalnu saradnju u oblasti zakonodavstva ima sledeće dužnosti i odgovornosti:
1.1. Ofrimi i shërbimeve këshillimore, opinioneve, sqarimeve dhe ekspertizës juridike për Zyrën e Kryeministrit dhe	1.1. Providing advisory services, opinions, explanations and legal expertise for the Office of the Prime Minister and	1.1. Pružanje savetodavnih usluga, mišljenja, objašnjenja i pravne ekspertize za Kancelariju premijera i

Qeverinë;	Government;	Vladu;
1.2. Bashkërendimi i procesit të Vlerësimit Ex-Post të Legjislacionit, si dhe hartimi dhe përditësimi i Udhërrëfyesit për Vlerësimin Ex-Post të Legjislacionit bazuar në praktikat më të mira, si dhe përditësimi dhe monitorimi i zbatimit të tyre;	1.2. Coordination of the process of Ex-Post Assessment of legislation, drafting and updating the Roadmap for Ex-Post Assessment of Legislation based on best practices, as well as updating and monitoring their implementation;	1.2. Koordinacija u procesu Ex-post procene zakonodavstva, izrada i ažuriranje Vodiča za Ex-post procenu zakonodavstva na osnovu najboljih praksi, kao i ažuriranje i praćenje njihovog sprovođenja;
1.3. Bashkërendimi i punës me Grupin Mbikëqyrës për Vlerësimin Ex-Post të Legjislacionit;	1.3. Coordination of work with the Monitoring Group for Ex-Post Assessment of Legislation;	1.3. Koordinacija rada sa Nadzornom grupom za Ex-Post procenu zakonodavstva;
1.4. Bashkërendimi i procesit të përgatitjes së Programit për Vlerësimin Ex-Post të Legjislacionit si dhe monitorimi i zbatimit të tij;	1.4. Coordination of the process for preparing the Program for Ex-Post Assessment of Legislation, as well as monitoring its implementation;	1.4. Koordinacija procesa pripreme Programa za Ex-Post procenu zakonodavstva, kao i praćenje njegovog sprovođenja;
1.5. Pjesëmarrja në hartimin e koncept dokumenteve dhe dokumenteve strategjike dhe shqyrtimi për të siguruar që rekomandimet në to janë në përputhje me Kushtetutën dhe kornizën ekzistuese ligjore si dhe për të siguruar nëse është identifikuar nevoja për miratimin e ligjeve apo akteve nënligjore të nevojshme;	1.5. Participation in drafting the concept documents and strategic documents and their review to ensure that recommendations therein comply with the Constitution and the existing legal framework, as well as to ensure whether the need for adopting necessary laws or sub-legal acts has been identified;	1.5. Učestvujte u izradi koncept dokumenata i strateških dokumenata i pregledajte ih kako biste bili sigurni da su preporuke u njima u skladu sa Ustavom i postojećim pravnim okvirom, kao i da li je utvrđena potreba za usvajanjem potrebnih zakona ili podzakonskih akata.
1.6. Mbajtja dhe përditësimi i Regjistrit të të gjitha akteve nënligjore të miratuara nga Qeveria dhe ministritë;	1.6. Keeping and updating the register of all sub-legal acts adopted by the Government and ministries;	1.6. Vođenje i ažuriranje Registra svih podzakonskih akata koje je usvojila Vlada i ministarstva;

2. Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit raporton te Drejtori i Zyrës.	2. The Head of the Division for Monitoring the Implementation of Legislation, Legal Support and Interinstitutional Cooperation in the Field of Legislation shall report to the Director of Office.	2. Rukovodilac Odseka za nadgledanje sprovođenja zakonodavstva, pravnu podršku i međuinstitucionalnu saradnju u oblasti zakonodavstva izveštava direktoru Kancelarije.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit është tre (3).	3. Number of employees in the Division for Monitoring the Implementation of Legislation, Legal Support and Interinstitutional Cooperation in the Field of Legislation shall be three (3).	3. Broj zaposlenih u Odseku za nadgledanje sprovođenja zakonodavstva, pravnu podršku i međuinstitucionalnu saradnju u oblasti zakonodavstva je tri (3).
Neni 11 **Divizioni për Zvogëlimin e Barrës Administrative nëpërmjet Thjeshtimit të Lejeve dhe Licencave**	**Article 11** **Division for Administrative Burden Reduction by Simplifying Permits and Licences**	**Član 11** **Odsek za smanjenje administrativnog opterećenja pojednostavljenjem dozvola i licenci**
1.6. Ofrimi i mbështetjes për zhvillimin e programeve të ngritjes së kapaciteteve, lidhur me procesin e koordinimit të bashkëpunimit për zhvillim, për institucionet përgjegjëse në fushën e administratës publike dhe sundimit të ligjit.	1.6. Providing support for the development of capacity building programs, related to the process of coordinating development cooperation, for responsible institutions in the field of public administration and rule of law.	1.6. Pružanje podrške razvoju programa za izgradnju kapaciteta, u vezi sa procesom koordinacije saradnje za razvoj, za odgovorne institucije u oblasti javne uprave i vladavine prava.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Administratën Publike dhe Sundimin e Ligjit raporton te Drejtori i Zyrës.	2. The Head of the Division for Public Administration and Rule of Law shall report to the Director of Office.	2. Rukovodilac Odseka za javnu upravu i vladavinu prava izveštava direktoru Kancelarije.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Administratën Publike dhe Sundimin e Ligjit është katër (4).	3. The number of employees in the Division for Public Administration and Rule of Law shall be four (4).	3. Broj zaposlenih u Odseku za javnu upravu i vladavinu prava je četiri (4).
Neni 44 **Divizioni për Zhvillim Ekonomik dhe Social**	**Article 44** **Division for Economic and Social Development**	**Član 44** **Odsek za ekonomski i socijalni razvoj**
1. Detyrat dhe përgjegjësit e Divizionit për Zhvillim Ekonomik dhe Social janë:	1. The duties and responsibilities of the Division for Economic and Social Development shall be:	1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za ekonomski i socijalni razvoj su:
1.1. Koordinimi i planifikimit dhe programimit të ndihmës së BE-së dhe	1.1. Coordination of planning and programming of EU and other donor	1.1. Koordinacija planiranja i programiranja pomoći EU-a i drugih

donatorëve të tjerë, në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social;	assistance in the field of economic and social development;	donatora, u oblasti ekonomskog i socijalnog razvoja;
1.2. Ofrimi i mbështetjes për përgatitjen e politikave dhe dokumenteve strategjike për sa i përket bashkëpunimit për zhvillim, në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social;	1.2. Providing support for the preparation of policies and strategic documents regarding development cooperation in the field of economic and social development;	1.2. Pružanje podrške za pripremu strateških politika i dokumenata u vezi sa razvojnom saradnjom u oblasti ekonomskog i socijalnog razvoja;
1.3. Ofrimi i mbështetjes për koordinimin e ndihmës në kuadër të nismave rajonale të BE-së, në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social;	1.3. Providing support for the coordination of assistance in the framework of EU regional initiatives in the field of economic and social development;	1.3. Pružanje podrške za koordinaciju pomoći u okviru regionalnih inicijativa EU-a, u oblasti ekonomskog i socijalnog razvoja;
1.4. Ofrimi i mbështetjes për përgatitjen e marrëveshjeve financiare ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe BE-së, në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social;	1.4. Providing support for the preparation of financial agreements between the institutions of the Republic of Kosovo and the EU in the field of economic and social development;	1.4. Pružanje podrške za pripremu finansijskih sporazuma između institucija Republike Kosovo i EU-a, u oblasti ekonomskog i socijalnog razvoja;
1.5. Ofrimi i mbështetjes për aktivitetet e strukturave për koordinimin e donatorëve në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social;	1.5. Providing support for the activities of donor coordination structures in the field of economic and social development;	1.5. Pružanje podrške aktivnostima struktura za koordinaciju donatora, u oblasti ekonomskog i socijalnog razvoja;
1.6. Ofrimi i mbështetjes për zhvillimin e programeve të ngritjes së kapaciteteve, lidhur me procesin e koordinimit të bashkëpunimit për zhvillim, për institucionet përgjegjëse në fushën e zhvillimit ekonomik dhe	1.6. Providing support for the development of capacity building programs, related to the process of coordinating development cooperation, for responsible institutions in the field of economic and social development.	1.6. Pružanje podrške razvoju programa za izgradnju kapaciteta, u vezi sa procesom koordinacije saradnje za razvoj, za odgovorne institucije u oblasti ekonomskog i socijalnog razvoja.

social.		
2. Udhëheqësi i Divizionit për Zhvillim Ekonomik dhe Social raporton te Drejtori i Zyrës.	2. The Head of the Division for Economic and Social Development shall report to the Director of Office.	2. Rukovodilac Odseka za ekonomski i socijalni razvoj izveštava direktoru Kancelarije.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Zhvillim Ekonomik dhe Social është pesë (5).	3. The number of employees in the Division for Economic and Social Development shall be five (5).	3. Broj zaposlenih u Odseku za ekonomski i socijalni razvoj je pet (5).
Neni 45 **Zyra për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**	**Article 45** **Office for Issues of Categories Deriving from the War of the Kosovo Liberation Army**	**Član 45** **Kancelarija za pitanja kategorija proizašlih iz rata Oslobodilačke Vojske Kosova**
1. Zyra për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (ZÇKDL e UÇK-së) është njësi organizative në kuadër të Zyrës së Kryeministrit e cila ka për mision të krijojë mundësi për realizimin e të drejtave ligjore për kategoritë e dala nga lufta, si dhe të kujdeset për mirëqenien e tyre, në koordinim me institucionet qendrore, lokale si dhe organizatat relevante.	1. The Office for Issues of Categories Deriving from the War of the Kosovo Liberation Army (OICDW of KLA) is an organizational unit within the Office of the Prime Minister, with the mission to create opportunities for the realization of legal rights for categories emerged from the war and to take care of their well-being in coordination with central, local institutions and relevant organizations.	1. Kancelarija za pitanja kategorija proizašlih iz rata Oslobodilačke Vojske Kosova (KPKPR OVK-a) je organizaciona jedinica u okviru Kancelarije premijera koja ima za misiju da stvara mogućnosti za ostvarivanje zakonskih prava za kategorije proizašle iz rata, i takođe da se brine o njihovom blagostanju u koordinaciji sa lokalnim i centralnim institucijama i sa relevantnim organizacijama.
2. Zyra për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës bashkërendon dhe koordinon aktivitetet për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, sipas legjislacionit pëkatës në fuqi për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve,	2. The Office for Issues of Categories Deriving from the War of the Kosovo Liberation Army aligns and coordinates the activities for the categories emerged from the KLA War, according to the relevant legislation in force on the Status and Rights	2. Kancelarija za pitanja kategorija proizašlih iz rata Oslobodilačke Vojske Kosova koordinira aktivnosti za kategorije proizašlih iz rata OVK-a, u skladu sa relevantnim zakonodavstvom na snazi, za status i prava palih boraca, invalida,

invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.	of Martyrs, Invalids, Veterans, Members of Kosovo Liberation Army.	veterana i pripadnika Oslobodilačke Vojske Kosova.
3. Përgjegjësitë, fushëveprimi, rregullat dhe procedurat e punës së Zyrës për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë të përcaktuara me ligjin përkatës për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me Rregulloren përkatëse për Zyrën.	3. Responsibilities, scope, rules and working procedures of the Office for Issues of Categories Deriving from the War of the Kosovo Liberation Army are defined by the relevant law on the Status and Rights of Martyrs, Invalids, Veterans, Members of the Kosovo Liberation Army and the relevant Regulation of the Office.	3. Odgovornosti, delokrug, pravila i procedure rada Kancelarije za pitanja kategorija proizašlih iz rata Oslobodilačke Vojske Kosova, utvrđene relevantne zakona o statusu i pravima palih boraca, invalida, veterana i pripadnika Oslobodilačke Vojske Kosova i relevantnom Uredbom o kancelariji.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë:	4. The duties and responsibilities of the Office for Issues of Categories Deriving from the War of the Kosovo Liberation Army shall be:	4. Dužnosti i odgovornosti Kancelarije za pitanja kategorija proizašlih iz rata Oslobodilačke Vojske Kosova za razvoj su:
4.1. Mbajtja dhe përditësimi i Regjistrit Qendror për dëshmorët e kombit, invalidët e UÇK-së, veteranët, pjesëtarët e UÇK-së dhe për të internuarit e UÇK-së, viktimat civile dhe invalidët civil të luftës;	4.1. Maintaining and updating the Central Register for the nation's martyrs, KLA invalids, veterans, KLA members and KLA internees, civilian victims and civilian war invalids;	4.1. Održavanje i ažuriranje Centralni registar za narodne heroje, invalide OVK-a, veterane, pripadnike OVK-a i za internirane pripadnike OVK-a, civilne žrtve i civilne invalide rata;
4.2. Lëshimi i Vërtetimeve duke u bazuar në Regjistrin Qendror për të gjitha kategoritë;	4.2. Issuing Certificates based on the Central Register for all categories;	4.2. Izdavanje potvrde na osnovu Centralnog registra za sve kategorije;
4.3 Trajtimi i kërkesave dhe nevojave për kategoritë e dala nga Lufta përfshirë tretmanet shëndetësore kolektive dhe individuale si dhe	4.3 Handling of the requests and needs for the categories emerged from the War, including the collective and individual health treatments, as well as the	4.3 Rukovanje zahtevima i potrebama za kategorije proizašle iz rata, uključujući kolektivne i individualne zdravstvene tretmane, kao i

rehabilitimin e kategorive të përfshira në ligj;	rehabilitation of the categories included in the law;	rehabilitaciju kategorija obuhvaćenih zakonom;
4.4. Ruajtja e dokumentacionit të Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të UÇK-ës, i cili trajtohet si dokument i klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin e informatave dhe ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;	4.4. Preserving the documentation of the Government Commission for the recognition and verification of the status of nation's martyr, invalid, veteran, member or internee of the KLA, which is treated as a classified document according to the legislation in force for the classification of information and the law in force for personal data protection;	4.4. Očuvanje dokumentaciju Vladine komisije za priznavanje i verifikaciju statusa narodnog heroja, invalida, veterana, pripadnika ili interniranog pripadnika OVK-a, koji se vode kao klasifikovani dokumenti u skladu sa važećim zakonodavstvom o klasifikaciji informacija i važećeg zakona o zaštiti ličnih podataka;
4.5. Bashkëpunimi me ministritë përkatëse, DFDIL/MPMS dhe Zyrat komunale të nivelit lokal për çështje të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së;	4.5. Cooperating with the relevant Ministries, DMFWI/MLSW and Municipal Offices at the local level on issues of categories emerged from the KLA war;	4.5. Saradnja sa relevantnim ministarstvima, OPPBRI/MRSZ i opštinskim kancelarijama lokalnog nivoa po pitanjima kategorija proizašlih iz rata OVK-a;
4.6. Lëshimi i Dekoratës: Familje Veterani pas vdekjes së Veteranit të UÇK-së;	4.6. Issuing Decoration: Veteran Family after the death of a KLA Veteran;	4.6. Izdavanje odlikovanje: Veteran nakon smrti veterana OVK-a;
4.7. Organizimi i "Epopesë së UÇK-së", "Ditës së Veteranit" dhe të gjitha manifestimeve tjera që lidhen me Luftën e UÇK-së si dhe përcakton kalendarin vjetor te datave përkujtimore;	4.7. Organization of the "KLA Epopee", "Veteran's Day" and all other events related to the KLA War and determines the annual calendar of commemorative dates;	4.7. Organizacija "Epopeje OVK-a", "Dana veterana" i svim drugim manifestacijama koje se odnose na rat OVK-a, i takođe određuje godišnji kalendar spomen datuma;
4.8. Mbajtja dhe përditësimi i ueb faqes së Zyrës;	4.8. Maintaining and updating the website of the Office;	4.8. Održavanje i ažuriranje internet stranicu Kancelarije;

4.9. Bashkërendimi i aktiviteteve për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së të përcaktuara me ligj;	4.9. Coordinating of the activities for the categories emerged from the KLA war defined by law;	4.9. Koordinacija aktivnosti za kategorije proistekle iz rata OVK definisanih zakonom;
4.10. Ofrimi i ndihmës në hartimin e akteve përkatëse ligjore dhe nënligjore, në bashkëpunim me organizatat e dala nga lufta dhe në konsultim me institucionet tjera përkatëse publike;	4.10. Assisting in drafting relevant legal acts and bylaws, in cooperation with organizations emerged from war and in consultation with other relevant public institutions;	4.10. Pomaganje u izradi relevantnih pravnih akata i podzakonskih akata, u saradnji sa organizacijama proisteklim iz rata i uz konsultacije sa drugim relevantnim javnim institucijama;
4.11. Bashkëpunimi me Organizatat e dala nga lufta, për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të kategorive të përcaktuara me Ligjin përkatës;	4.11. Cooperating with the organizations emerged from the war, for the protection and promotion of the interests of the categories defined by the relevant law;	4.11. Sarađuje sa organizacijama proizašlih iz rata, za zaštitu i promovisanje interesa kategorija utvrđenih Zakonom;
4.12. Hulumtimi, ndërmjetësimi dhe nxitja e punësimit për kategoritë e dala nga Lufta e UÇK-së;	4.12. Researching, mediating and promoting employment for categories emerged from the KLA war;	4.12. Istraživanje, posredovanje i promocija zapošljavanje za kategorije proizašlih iz rata OVK-a;
4.13. Propozimi i kërkesës për ndarje buxhetore për funksionimin e zyrës si dhe realizimin e projekteve të propozuara (në Kodin e veçantë buxhetor të ZÇKDL-së, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit);	4.13. Proposing the request for budget allocation for the functioning of the office, as well as the implementation of projects proposed (in the special budget code of OICDW, within the Office of the Prime Minister);	4.13. Predlaganje zahteva za dodelu budžeta za funkcionisanje kancelarije, kao i realizaciju projekata predloženih (u posebnoj budžetskoj stavci KPKPR-a, u okviru Kancelarije premijera);
4.14. Krijimi i lehtësirave të ndryshme dhe ndarja e granteve dhe subvencioneve për zhvillimin e veprimtarive të veteranëve dhe invalidëve luftëtar si dhe lehtësira të ndryshme administrative, tatimore dhe	4.14. Creating various facilities and allocates grants and subsidies for the development of activities of war veterans and invalids, as well as various administrative, tax and customs reliefs;	4.14. Stvaranje raznih objekata i deli grantove i subvencije za sprovođenje delatnosti veterana i invalida boraca, i različite administrativne, poreske i carinske olakšice;

doganore;		
4.15. Ofrimi i shërbimeve pa pagesë kategorive të dala nga lufta e UÇK-së.	4.15. Providing free services to categories emerged from the KLA war.	4.15. Pružanje besplatne usluge kategorijama proizašlih iz rata OVK-a.
5. Zyra për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kryen edhe detyrat dhe përgjegjësitë tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe detyrat e përcaktuara nga Kryeministri dhe Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së.	5. The Office for Issues of the Categories Deriving from the War of the Kosovo Liberation Army carries out other duties and responsibilities as set out in the legislation in force and duties assigned by the Prime Minister and Secretary General of OPM.	5. Kancelarije za pitanja kategorija proizašlih iz rata Oslobodilačke Vojske Kosova obavlja i druge dužnosti i odgovornosti utvrđene važećim zakonodavstvom, kao i dužnosti utvrđene od strane Premijera i Generalnog Sekretara KP-a.
6. Drejtori i Zyrës për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i raporton dhe i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm.	6. The Director of the Office for Issues of the Categories Deriving from the War of the Kosovo Liberation Army shall report and respond to the Secretary General.	6. Direktor Kancelarije za pitanja kategorija proizašlih iz rata Oslobodilačke Vojske Kosova izveštava i odgovara Generalnom sekretaru.
7. Në kuadër të Zyrës për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës bëjnë pjesë divizionet si në vijim:	7. The following divisions shall be part of the Office for Issues of the Categories Deriving from the War of the Kosovo Liberation Army:	7. U okviru Kancelarije za pitanja kategorija proizašlih iz rata Oslobodilačke Vojske Kosova spadaju sledeći odseci:
7.1. Divizioni për Veteranët e luftës së UÇK-së;	7.1. Division for KLA War Veterans;	7.1. Odsek za ratne veterane OVK-a;
7.2. Divizioni për Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidët e luftës së UÇK-së.	7.2. Division for Martyrs' Families and KLA War Invalids.	7.2. Odsek za porodice palih boraca i ratnih invalida OVK-a.
8. Numri i të punësuarve në Zyrën për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është	8. The number of employees in the Office for Issues of the Categories Deriving from the War of the Kosovo Liberation Army	8. Broj zaposlenih u Kancelariji za pitanja kategorija proizašlih iz rata Oslobodilačke Vojske Kosova je sedam (7).

shtatë (7).	shall be seven (7).	
Neni 46 **Divizioni për Veteranët e luftës së UÇK-së**	**Article 46** **Division for KLA War Veterans**	**Član 46** **Odsek za ratne veterane OVK-a**
1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Veteranët e luftës së UÇK-së janë:	1. The duties and responsibilities of the Division for KLA War Veterans shall be:	1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za ratne veterane OVK-a su:
1.1. Mbajtja dhe përditësimi i Regjistrit Qendror për veteranët, pjesëtarët e UÇK-së;	1.1. Maintaining and updating the Central Register for the veterans, KLA members;	1.1. Održavanje i ažuriranje Centralni registar za veterane, pripadnike OVK-a;
1.2. Lëshimi i Vërtetimeve duke u bazuar në Regjistrin Qendror për veteranët;	1.2. Issuing Certificates based on the Central Register for veterans;	1.2. Izdavanje potvrde na osnovu Centralnog registra za veterane;
1.3. Ruajtja e dokumentacionit të Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të UÇK-ës, i cili trajtohet si dokument i klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin e informatave dhe ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;	1.3. Preserving the documentation of the Government Commission for the recognition and verification of the status of veteran, member or internee of the KLA, which is treated as a classified document according to the legislation in force for the classification of information and the law in force for personal data protection;	1.3. Očuvanje dokumentaciju Vladine komisije za priznavanje i verifikaciju statusa veterana, pripadnika ili interniranog pripadnika OVK-a, koji se vode kao klasifikovani dokumenti u skladu sa važećim zakonodavstvom o klasifikaciji informacija i važećeg zakona o zaštiti ličnih podataka;
1.4. Lëshimi i Dekoratës: Familje Veterani pas vdekjes së Veteranit të UÇK-së;	1.4. Issuing Decoration: Veteran Family after the death of a KLA Veteran;	1.4. Izdavanje odlikovanje: Veteran nakon smrti veterana OVK-a;
1.5. Organizimi i "Epopesë së UÇK-së", "Ditës së Veteranit" dhe të gjitha	1.5. Organization of the "KLA Epopee", "Veteran's Day" and all other events	1.5. Organizacija "Epopeje OVK-a", "Dana veterana" i svim drugim

manifestimeve tjera që lidhen me Luftën e UÇK-së si dhe përcakton kalendarin vjetor te datave përkujtimore;	related to the KLA War and determines the annual calendar of commemorative dates;	manifestacijama koje se odnose na rat OVK-a, i takođe određuje godišnji kalendar spomen datuma;
1.6. Mbajtja dhe përditësimi i ueb faqes së Zyrës;	1.6. Maintaining and updating the website of the Office;	1.6. Održavanje i ažuriranje internet stranicu Kancelarije;
1.7. Bashkërendimi i aktiviteteve për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së të përcaktuara me ligj;	1.7. Coordinating of the activities for the categories emerged from the KLA war defined by law;	1.7. Koordinacija aktivnosti za kategorije proistekle iz rata OVK definisanih zakonom;
1.8. Ofrimi i ndihmës në hartimin e akteve përkatëse ligjore dhe nënligjore, në bashkëpunim me organizatat e dala nga lufta dhe në konsultim me institucionet tjera përkatëse publike;	1.8. Assisting in drafting relevant legal acts and bylaws, in cooperation with organizations emerged from war and in consultation with other relevant public institutions;	1.8. Pomaganje u izradi relevantnih pravnih akata i podzakonskih akata, u saradnji sa organizacijama proisteklim iz rata i uz konsultacije sa drugim relevantnim javnim institucijama;
1.9. Bashkëpunimi me Organizatat e dala nga lufta, për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të veteranëve;	1.9. Cooperating with the organizations emerged from the war, for the protection and promotion of the interests of the veterans;	1.9. Saradnja sa organizacijama proisteklim iz rata, radi zaštite i promocije interesa veterana;
1.10. Hulumtimi, ndërmjetësimi dhe nxitja e punësimit për veteranët e Luftës së UÇK-së;	1.10. Researching, mediating and promoting employment for veterans of the KLA war;	1.10. Istraživanje, posredovanje i promocija zapošljavanja veterana iz rata OVK-a;
1.11. Propozimi i kërkesës për ndarje buxhetore për funksionimin e zyrës si dhe realizimin e projekteve të propozuara (në Kodin e veçantë buxhetor të ZÇKDL-së, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit);	1.11. Proposing the request for budget allocation for the functioning of the office, as well as the implementation of projects proposed (in the special budget code of OICDW, within the Office of the Prime Minister);	1.11. Predlaganje zahteva za dodelu budžeta za funkcionisanje kancelarije, kao i realizaciju projekata predloženih (u posebnoj budžetskoj stavci KPKPR-a, u okviru Kancelarije premijera);

1.12. Krijimi i lehtësirave të ndryshme dhe ndarja e granteve dhe subvencioneve për zhvillimin e veprimtarive të veteranëve, si dhe lehtësira të ndryshme administrative, tatimore dhe doganore.	1.12. Creating various facilities and allocates grants and subsidies for the development of activities of war veterans, as well as various administrative, tax and customs reliefs.	1.12. Stvaranje raznih objekata i deli grantove i subvencije za sprovođenje delatnosti veterana, i različite administrativne, poreske i carinske olakšice.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Veteranët e Luftës së UÇK-së i raporton Drejtorit të Zyrës.	2. The Head of the Division for KLA War Veterans shall report to the Director of Office.	2. Šef Odseka ratnih invalida OVK-a izveštava direktoru Kancelarije.
3. Numri i të punësuarve në kuadër të Divizionit për Veteranët e Luftës së UÇK-së është tre (3).	3. The number of employees within the Division for KLA War Veterans shall be three (3).	3. Broj zaposlenih u Odseku za ratne veterane OVK-a je tri (3).
Neni 47 **Divizioni për Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidët e Luftës së UÇK-së**	**Article 47** **Division for Families of Martyrs and KLA War Invalids**	**Član 47** **Odsek za porodice palih boraca i ratne invalide OVK-a**
1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidët e Luftës së UÇK-së janë:	1. The duties and responsibilities of the Division for Families of Martyrs and KLA War Invalids shall be:	1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za porodice palih boraca i ratne invalide OVK su:
1.1. Mbajtja dhe përditësimi i Regjistrit Qendror për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e Luftës së UÇK-së;	1.1. Maintaining and updating the Central Register for the families of Martyrs and KLA war invalids;	1.1. Održavanje i ažuriranje Centralni registar za porodice palih boraca i ratne invalide OVK-a;
1.2. Lëshimi i Vërtetimeve duke u bazuar në Regjistrin Qendror për dëshmorët dhe invalidët e Luftës së UÇK-së;	1.2. Issuing Certificates based on the Central Register for Martyrs and KLA War Invalids;	1.2. Izdavanje potvrda na osnovu Centralnog registra za mučenike i ratne vojne invalide OVK;

1.3. Ruajtja e dokumentacionit të Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorëve dhe invalidëve të Luftës së UÇK-ës, i cili trajtohet si dokument i klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin e informatave dhe ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;	1.3. Preserving the documentation of the Government Commission for the recognition and verification of the status of Martyrs and KLA war invalids, which is treated as a classified document according to the legislation in force for the classification of information and the law in force for personal data protection;	1.3. Očuvanje dokumentaciju Vladine komisije za priznavanje i verifikaciju statusa mučenike i ratne vojne invalide OVK, pripadnika ili interniranog pripadnika OVK-a, koji se vode kao klasifikovani dokumenti u skladu sa važećim zakonodavstvom o klasifikaciji informacija i važećeg zakona o zaštiti ličnih podataka;
1.4. Bashkëpunimi me Shoqatat e dala nga lufta, për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të Luftës së UÇK-së;	1.4. Cooperating with the organizations emerged from the war, for the protection and promotion of the interests of the families of martyrs and KLA War invalids;	1.4. Saradnja sa organizacijama proisteklim iz rata, radi zaštite i promocije interesa porodice palih boraca i ratne invalide OVK-a;
1.5. Hulumtimi, ndërmjetësimi dhe nxitja e punësimit për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e Luftës së UÇK-së;	1.5. Researching, mediating and promoting employment for the families of martyrs and KLA War invalids;	1.5. Istraživanje, posredovanje i promocija zapošljavanja mučenike i ratne vojne invalide OVK-a iz rata OVK-a;
1.6. Krijimi i lehtësirave të ndryshme dhe ndarja e granteve dhe subvencioneve për zhvillimin e veprimtarive të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të Luftës së UÇK-së, si dhe lehtësira të ndryshme administrative, tatimore dhe doganore;	1.6. Creating various facilities and allocates grants and subsidies for the development of activities of of the families of martyrs and KLA War invalids, as well as various administrative, tax and customs reliefs;	1.6. Stvaranje različitih objekata i dodeljivanje grantova i subvencija za razvoj delatnosti porodica mučenika i ratnih vojnih invalida OVK, kao i raznih administrativnih, poreskih i carinskih olakšica;
2. Udhëheqësi i Divizionit për Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidët e Luftës së	2. The Head of the Division for Families of Martyrs and KLA War Invalids shall report	2. Šef Odseka za porodice palih boraca i ratne invalide OVK-a izveštava direktoru

UÇK-së i raporton Drejtorit të Zyrës.	to the Director of Office.	Kancelarije.
3. Numri i të punësuarve në kuadër të Divizionit për Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidët e Luftës së UÇK-së është tre (3).	3. The number of employees within the Division for Families of Martyrs and KLA War Invalids shall be three (3).	3. Broj zaposlenih u okviru Odseka za porodice palih boraca i ratne invalide OVK-a je tri (3).
Neni 48 **Zyra për Çështje të Komuniteteve**	**Article 48** **Office for Community Affairs**	**Član 48** **Kancelarija za pitanja zajednica**
1. Zyra për Çështje të Komuniteteve është njësi organizative në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila ka për mision të ndihmojë Zyrën e Kryeministrit dhe Qeverinë në përcaktimin dhe zbatimin e politikave në mënyrë të unifikuar dhe koherente, duke analizuar, këshilluar dhe mbështetur hartimin e politikave për çështje të komuniteteve dhe monitorimin e zbatimit të tyre.	1. The Office of Community Affairs is an organizational unit within the Office of the Prime Minister, with the mission to assist the Office of the Prime Minister and the Government in defining and implementing policies in a unified and coherent manner, by analysing, advising and supporting the drafting of policies for community issues and monitoring their implementation.	1. Kancelarija za pitanja zajednica je organizaciona jedinica u okviru Kancelarije premijera, čija je misija da pomogne Kancelariji premijera i Vladi u definisanju i sprovođenju politika na jedinstven i koherentan način, analiziranjem, savetovanjem i podrškom u izradi politika o pitanjima zajednice i praćenju njihove primene.
2. Zyra për Çështje të Komuniteteve ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:	2. The Office for Community Affairs shall have the following duties and responsibilities:	2. Kancelarija za pitanja zajednica ima sledeće dužnosti i odgovornosti:
2.1. Ofrimi i këshillave për Zyrën e Kryeministrit dhe Qeverinë në çështje të ndërlidhura me komunitetet përshirë çështjet e rëndësishme me interes shtetëror;	2.1. Providing advice to the Office of the Prime Minister and the Government on community-related issues including important issues of state interest;	2.1. Pružanje saveta Kancelariji premijera i Vladi o pitanjima vezanim za zajednice, uključujući važna pitanja od državnog interesa;
2.2. Shfrytëzimi i fondeve të saj në mënyrë transparente, për të përmbushur nevojat e komuniteteve,	2.2. Use of its funds in a transparent manner, to meet the needs of communities, in accordance with	2.2. Korišćenje njenih sredstava na transparentan način za zadovoljavanje potreba zajednica, u skladu sa važećim

në pajtim me legjislacionin në fuqi, si dhe monitorimi i tyre;	applicable law, and their monitoring;	zakonodavstvom, kao i njihovo nadgledanje;
2.3. Koordinimi i çështjeve që lidhen me komunitetet për të siguruar që çështjet e komuniteteve janë marrë parasysh në mënyrë të efektshme në tërë Kosovën;	2.3. Coordination of community-related issues, to ensure that community issues are effectively addressed throughout Kosovo;	2.3. Koordinacija pitanja vezanim za zajednice, kako bi se osiguralo da se pitanja zajednica efikasno rešavaju širom Kosova;
2.4. Ofrimi i ndihmës në zhvillimin e politikave dhe legjislacionit që ndërlidhet me çështjet e komuniteteve;	2.4. Providing assistance in developing policies and legislation related to community affairs;	2.4. Pružanje pomoći u razvoju politika i zakonodavstva vezanim za pitanja zajednica;
2.5. Adresimi i nevojave praktike të komuniteteve përmes shfrytëzimit efikas dhe transparent të fondeve në dispozicion për të pasur efekt pozitiv dhe për të krijuar ndryshime në jetën e njerëzve, me theks të veçantë për ata që janë më në nevojë;	2.5. Addressing the practical needs of communities through the efficient and transparent use of available funds in order to have a positive effect and create change in people's lives, with special emphasis on those most in need;	2.5. Rešavanje praktičnih potreba zajednica putem efikasne i transparentne upotrebe raspoloživih sredstava kako bi imalo pozitivan efekat i stvorila promena u životu ljudi, sa posebnim naglaskom na one kojima su najpotrebnije;
2.6. Konsultimi me komunitetet dhe shoqërinë civile dhe krijimi i një partneriteti kuptimplotë përmes besimit, mirëkuptimit, shkëmbimit të njohurive dhe konsultimit dhe mobilizimit efektiv në komunitet për të ushqyer dhe nxitur prosperitetin në komunitetet;	2.6. Consultation with communities and civil society and building a meaningful partnership through trust, understanding, knowledge sharing and effective community consultation and mobilization to nurture and promote prosperity in communities;	2.6. Konsultacije sa zajednicama i civilnim društvom i izgradnja značajnog partnerstva kroz poverenje, razumevanje, razmenu znanja i efikasne konsultacije i mobilizacije u zajednici radi negovanja i podsticanja prosperiteta u zajednicama;
2.7. Promovimi i trajtimit të barabartë të komuniteteve.	2.7. Promotion of equal treatment of communities.	2.7. Promocija jednakog tretmana zajednica.

3. Zyra për Çështje të Komuniteteve kryen edhe detyrat dhe përgjegjësitë tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe detyrat e përcaktuara nga Kryeministri dhe Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së.	3. The Office for Community Affairs carries out other duties and responsibilities as set out in the legislation in force and duties assigned by the Prime Minister and Secretary General of OPM.	3. Kancelarije za pitanja zajednica obavlja i druge dužnosti i odgovornosti utvrđene važećim zakonodavstvom, kao i dužnosti utvrđene od strane Premijera i Generalnog Sekretara KP-a.
4. Drejtori i Zyrës për Çështje të Komuniteteve i raporton dhe i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm.	4. The Director of the Office for Community Affairs shall report and respond to the Secretary General.	4. Direktor Kancelarije za pitanja zajednica izveštava i odgovara generalnom sekretaru.
5. Në kuadër të Zyrës për Çështje të Komuniteteve bëjnë pjesë divizionet si në vijim:	5. The following divisions shall be part of the Office for Community Affairs:	5. U okviru Kancelarije za pitanja zajednica nalaze se sledeći odseci:
5.1. Divizioni për Politika të Komuniteteve;	5.1. Division for Community Policies;	5.1. Odsek za politike zajednica
5.2. Divizioni për Koordinim dhe Monitorim të Granteve dhe Subvencioneve.	5.2. Division for Coordination and Monitoring of Grants and Subsidies.	5.2. Odsek za koordinaciju i nadzor grantova i subvencija.
6. Numri i të punësuarve në Zyrën për Çështje të Komuniteteve është shtatë (7).	6. The number of employees in the Office for Community Affairs shall be seven (7).	6. Broj zaposlenih u Kancelariji za pitanja zajednica je sedam (7).
Neni 49 **Divizioni për Politika të Komuniteteve**	**Article 49** **Division for Community Policies**	**Član 49** **Odsek za politiku zajednica**
1. Divizioni për Politika të Komuniteteve ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:	1. The Division for Community Policies shall have the following duties and responsibilities:	1. Odsek za politiku zajednica ima sledeće dužnosti i odgovornosti:
1.1. Ofrimi i këshillave për Zyrën e Kryeministrit dhe Qeverinë në çështje të ndërlidhura me komunitetet përshirë	1.1. Providing advice to the Office of the Prime Minister and the Government on	1.1. Pružanje saveta Kancelariji premijera i Vladi o pitanjima vezanim za zajednice, uključujući važna pitanja

në çështje të rëndësishme me interes shtetëror;	issues related to communities, including important issues of state interest;	od državnog interesa;
1.2. Ofrimi i ndihmës në zhvillimin e politikave dhe legjislacionit që ndërlidhet me cështjet e komuniteteve;	1.2. Providing assistance in developing policies and legislation related to community issues;	1.2. Pružanje pomoći u razvoju politika i zakonodavstva vezanim za pitanja zajednica;
1.3. Konsultimi me komunitetet dhe shoqërinë civile dhe krijimi i një partneriteti kuptimplotë përmes besimit, mirëkuptimit, shkëmbimit të njohurive dhe konsultimit dhe mobilizimit efektiv në komunitet për të ushqyer dhe nxitur prosperitetin në komunitetet;	1.3. Consultation with communities and civil society and building a meaningful partnership through trust, understanding, knowledge sharing and effective community consultation and mobilization to nurture and promote prosperity in communities;	1.3. Konsultacije sa zajednicama i civilnim društvom i izgradnja značajnog partnerstva kroz poverenje, razumevanje, razmenu znanja i efikasne konsultacije i mobilizacije u zajednici radi negovanja i podsticanja prosperiteta u zajednicama;
1.4. Promovimi i trajtimit të barabartë të komuniteteve.	1.4. Promotion of equal treatment of communities.	1.4. Promocija jednakog tretmana zajednica.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Politika të Komuniteteve i raporton Drejtorit të Zyrës.	2. The Head of the Division for Community Policies shall report to the Director of Office.	2. Rukovodilac Odseka za politiku zajednica izveštava direktoru Kancelarije.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Politika të Komuniteteve është tre (3).	3. The number of employees in the Division for Community Policies shall be three (3).	3. Broj zaposlenih u Odseku za politiku zajednica je tri (3).
Neni 50 **Divizioni për Koordinim dhe Monitorim të Granteve dhe Subvencioneve**	**Article 50** **Division for Coordination and Monitoring of Grants and Subsidies**	**Član 50** **Odsek za koordinaciju i nadgledanje grantova i subvencija**
1. Divizioni për Koordinim dhe Monitorim të Granteve dhe	1. The Division for Coordination and Monitoring of Grants and Subsidies shall	1. Odsek za koordinaciju i nadgledanje grantova i subvencija ima sledeće dužnosti

Subvencioneve ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:	have the following duties and responsibilities:	i odgovornosti:
1.1. Shfrytëzimi i fondeve të saj në mënyrë transparente, për të përmbushur nevojat e komuniteteve, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si dhe monitorimi i tyre;	1.1. Use of its funds in a transparent manner, to meet the needs of communities, in accordance with applicable law, and their monitoring;	1.1. Korišćenje svojih sredstava na transparentan način za zadovoljavanje potreba zajednica, u skladu sa važećim zakonodavstvom, kao i njihovo nadgledanje;
1.2. Koordinimi i çështjeve që lidhen me komunitetet për të siguruar që çështjet e komuniteteve janë marrë parasysh në mënyrë të efektshme në tërë Kosovën;	1.2. Coordination of community-related issues to ensure that community issues are effectively addressed throughout Kosovo;	1.2. Koordinacija pitanja vezanim za zajednice, kako bi se osiguralo da se pitanja zajednica efikasno rešavaju širom Kosova;
1.3. Adresimi i nevojave praktike të komuniteteve përmes shfrytëzimit efikas dhe transparent të fondeve në dispozicion për të pasur efekt pozitiv dhe për të krijuar ndryshime në jetën e njerëzve, me theks të veçantë për ata që janë më në nevojë.	1.3. Addressing the practical needs of communities through the efficient and transparent use of available funds in order to have a positive effect and create change in people's lives, with particular emphasis on those most in need.	1.3. Rešavanje praktičnih potreba zajednica putem efikasne i transparentne upotrebe raspoloživih sredstava kako bi imalo pozitivan efekat i stvorila promena u životu ljudi, sa posebnim naglaskom na one kojima su najpotrebnije.
2. Udhëheqësi i Divizionit për Koordinim dhe Monitorim të Granteve dhe Subvencioneve i raporton Drejtorit të Zyrës.	2. The Head of the Division for Coordination and Monitoring of Grants and Subsidies shall report to the Director of Office.	2. Šef Odseka za koordinaciju i nadgledanje grantova i subvencija izveštava direktoru Kancelarije.
3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Koordinim dhe Monitorim të Granteve, Subvencioneve dhe Donacioneve është tre (3).	3. The number of employees in the Division for Coordination and Monitoring of Grants and Subsidies shall be three (3).	3. Broj zaposlenih u Odseku za koordinaciju i nadgledanje grantova i subvencija je tri (3).

Neni 51 Zyra për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme	Article 51 Office for Administration and General Services	Član 51 Kancelarija za opštu upravu i usluge
1. Zyra për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme (ZASHP) është njësi organizative në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ka për mision të ofrojë mbështetje administrative për njësitë brenda Zyrës së Kryeministrit.	1. The Office for Administration and General Services (OAGS) is an organizational unit within the Office of the Prime Minister, with the mission to provide administrative support to units within the Office of the Prime Minister.	1. Kancelarija za opštu upravu i usluge (KOUU) je organizaciona jedinica u okviru Kancelarije premijera čija je misija pružanje administrativne podrške jedinicama u Kancelariji premijera.
2. Zyra për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme ka detyrat dhe përgjegjësitë në vijim:	2. The Office for Administration and General Services shall have the following duties and responsibilities:	2. Kancelarija za opštu upravu i usluge ima sledeće dužnosti i odgovornosti:
2.1. Menaxhimi, koordinimi dhe ofrimi i shërbimeve administrative për të gjitha njësitë dhe organet në kuadër të ZKM-së;	2.1. Management, coordination, and providing administrative services for all units and bodies within the OPM;	2.1. Upravljanje, koordinacija, i pružanje administrativnih usluga svim jedinicama i organima u okviru KP-a;
2.2. Ofrimi i shërbimeve të përbashkëta për gjithë stafin e ZKM-së;	2.2. Providing joint services to all OPM staff;	2.2. Pružanje zajedničkih usluga za čitavo osoblje KP-a;
2.3. Mirëmbajtja e pajisjeve dhe ofrimi i shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe telekomunikimit;	2.3. Maintenance of equipment and providing information technology and telecommunication services;	2.3. Održavanje opreme i pružanje usluga informacione tehnologije i telekomunikacija;
2.4. Ofrimi i shërbimeve të përkthimit dhe lekturimit;	2.4. Providing translation and proofreading services;	2.4. Pružanje usluga prevođenja i lekture;
2.5. Sigurimi i funksionimit të logjistikës, transportin, depot,	2.5. Ensuring the functioning of logistics, transportation, warehouses,	2.5. Osiguranje funkcionisanja logistike, transporta, magacina,

materialet për zyre, dokumentacionin, dhe infrastrukturën e ZKM-së.	office supplies, documentation, and OPM infrastructure.	kancelarijskog materijala, dokumentacije, i infrastrukture KP-a.
3. Zyra për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme kryen detyrat dhe përgjegjësitë tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, si dhe detyrat e përcaktuara nga Kryeministri dhe Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së.	3. The Office for Administration and General Services shall perform other duties and responsibilities defined by the applicable legislation and duties defined by the Prime Minister and the Secretary General of the OPM.	3. Kancelarija za opštu upravu i usluge obavlja i druge dužnosti i odgovornosti utvrđene važećim zakonodavstvom, kao i dužnosti utvrđene od strane Premijera i Generalnog Sekretara KP-a.
4. Në kuadër të Zyrës për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme bëjnë pjesë divizionet si në vijim:	4. The following divisions shall be part of the Office of Administration and General Services:	4. U okviru Kancelarije za opštu upravu i usluge se nalaze sledeći odseci:
4.1. Divizioni për Teknologji Informative;	4.1. Division for Information Technology;	4.1. Odsek za informacionu tehnologiju;
4.2. Divizioni për Përkthime;	4.2. Division for Translation;	4.2. Odsek za prevođenje;
4.3. Divizioni për Logjistikë;	4.3. Division for Logistics;	4.3. Odsek za logistiku;
4.4. Divizioni për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv.	4.4. Division for Administration of Documents and Archive.	4.4. Odsek za upravljanje dokumentima i arhivu.
5. Numri i të punësuarve në Zyrën për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme është njëzetëenjë (21).	5. The number of employees in the Office of Administration and General Services shall be twenty-one (21).	5. Broj zaposlenih u Kancelariji za opštu upravu i usluge je dvadesetjedan (21).
Neni 52 **Divizioni për Teknologji Informative**	**Article 52** **Division for Information Technology**	**Član 52** **Odsek za informacionu tehnologiju**
1. Divizioni për Teknologji Informative ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:	1. The Division for Information Technology shall have the following duties and responsibilities:	1. Odsek za informacionu tehnologiju ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

1.1. Sigurimi që shërbimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të jenë efikase dhe efektive;	1.1. Ensuring that information and communication technology services are efficient and effective;	1.1. Osiguranje da su usluge informacione i komunikacione tehnologije efikasne i efektivne;
1.2. Hartimi i projekteve të Teknologjisë Informative në interes të ZKM-së;	1.2. Drafting Information Technology projects in the interest of the OPM;	1.2. Izrada projekte informacione tehnologije u interesu KP-a;
1.3. Ofrimi i mbështetjes së TI-së për stafin e ZKM-së;	1.3. Providing IT support to OPM staff;	1.3. Pružanje IT podršku osoblju KP-a;
1. Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është njësi organizative në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila ka për mision të sigurojë menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore përmes zhvillimit të procedurave, programeve dhe shërbimeve që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të Institucionit dhe punonjësve duke bërë balancimin e duhur të nevojave të punonjësve dhe nevojave të institucionit.	1. The Division for Human Resource Management is an organizational unit within the Office of the Prime Minister, with the mission to ensure effective management of human resources through the development of procedures, programs and services that contribute to achieving the goals of the Institution and employees by carrying out the appropriate balancing of the needs of employees and those of the institution.	1. Odeljenje za upravljanje ljudskim resursima je organizaciona jedinica u okviru Kancelarije Premijera, čija je misija da obezbedi efikasno upravljanje ljudskim resursima kroz izradu postupaka, programa i usluga koji balansiranjem doprinose postizanju ciljeva Institucije i zaposlenih primereno potrebama zaposlenih i potrebama ustanove.
2. Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka detyrat dhe përgjegjësitë si nëvijim:	2. The Division for Human Resource Management shall have the following duties and responsibilities:	2. Odsek za upravljanje ljudskim resursima ima sledeće dužnosti i odgovornosti:
2.1. Mbështetja dhe ofrimi i këshillave	2.1. Supporting and providing advice to	2.1. Podržati i pružiti savete najvišem

për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit, dhe/ose titullarin e institucionit për fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore;	the highest administrative head of the institution, and/or the head of the institution in the field of human resource management;	upravnom rukovodiocu institucije i/ili nosiocu institucije u oblasti upravljanja ljudskim resursima;
2.2. Sigurimi dhe ushtrimi i kompetencave në përputhje me autorizimet dhe përgjegjësitë në funksion të zbatimit të legjislacionit, dokumenteve, kërkesave, procedurave, standardeve për institucionin në fushën e burimeve njerëzore;	2.2. Provision and exercise of competencies in accordance with the authorizations and responsibilities in order to implement the legislation, documents, requirements, procedures, standards for the institution in the field of human resources;	2.2. Pružati i vršiti nadležnosti u skladu sa ovlašćenjima i odgovornostima u cilju sprovođenja zakona, dokumenata, zahteva, procedura, standarda za instituciju u oblasti ljudskih resursa;
2.3. Përgatitja e Planit vjetor dhe planit afatmesëm të personelit, në pajtim me procesin e planifikimit buxhetor të institucionit;	2.3. Preparing the annual and medium-term staff plan, in accordance with the budget planning process of the institution;	2.3. Pripremiti godišnji plan i srednjoročnog plana osoblja, u skladu sa procesom planiranja budžeta institucije;
2.4. Ofrimi i ndihmës për njësitë përkatëse në përgatitjen e përshkrimit të vendeve të punës, klasifikimin e vendeve të punës dhe sistematizimin e vendeve të punës;	2.4. Providing assistance to relevant units in the preparation of job descriptions, job classification and job systematization;	2.4. Pružiti pomoć relevantnim jedinicama u pripremi opisa radnih mesta, klasifikaciji radnih mesta i sistematizaciji radnih mesta;
2.5. Zhvillimi i procedurave të lëvizjes brenda kategorisë dhe ngritjes në detyrë për nëpunësit civil deri në plotësimin e vendit të punës në bazë të legjislacionit në fuqi;	2.5. Developing procedures for moving within the category and promotion of civil servants until the job position is filled according to the legislation in force;	2.5. Izrađivanje procedura za kretanje unutar kategorije i unapređenje civilnih službenika do popunjavanja radnog mesta u skladu sa važećim zakonodavstvom;
2.6. Në bashkërendim me udhëheqësit e njësive identifikon dhe vlerëson në mënyrë periodike, nevojat për	2.6. In coordination with the heads of the units, on a periodical manner, identify and assess the needs for training	2.6. U koordinaciji sa rukovodiocima jedinica, periodično identifikovati i proceniti potrebe za obukom civilnih

aftësimin e nëpunësve civil të institucionit për aftësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale permes trajnimit për zhvillim në karrierë dhe ngritje në detyrë.;	of the civil servants of the institution for training and development of professional capacities through training for career development and promotion;	službenika institucija za osposobljavanje i razvoj profesionalnih kapaciteta kroz obuku za razvoj karijere i unapređenje;
2.7. Menaxhimi i proceseve që lidhen me emërimet, lirimet, transferimet, pezullimet, pensiomimin, konfirmimet e nëpunësve civilë në Zyrën e Kryeministrit dhe kategorive tjera në kuptimin e ligjit përkatës për zyrtarët publik;	2.7. Management of processes related to appointments, dismissals, transfers, suspensions, retirement, confirmations of civil servants in the Office of the Prime Minister and other categories within the meaning of the relevant Law on Public Officials;	2.7. Upravljanje procesima u vezi sa imenovanjima, otkazima, premeštajima, suspenzijama, penzionisanjem, potvrđivanjem civilnih službenika u Kabinetu premijera i drugim kategorijama u smislu odgovarajućeg Zakona o javnim službenicima;
2.8. Sigurimi i zbatimit të procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë, vijueshmërinë në punë përmes platformës elektronike (SMVP) Sistemi i Menaxhimit të Vijueshmërisë në Punë;	2.8. Ensuring the implementation of procedures for the assessment of work results, attendance at work through the electronic platform Work Attendance Management System (WAMS);	2.8. Obezbeđivanje sprovođenja procedura za ocenjivanje rezultata na radu, prisustvo na poslu putem elektronske platforme (SUPP) Sistem za upravljanje prisustvom na poslu;
2.9. Menaxhimi i procedurave disiplinore dhe procedurave për komision të ankesave për nëpunësit civil dhe zyrtarët publik;	2.9. Managing disciplinary and complaints commission procedures for civil servants and public officials;	2.9. Upravljanje disciplinskim postupcima i postupcima za žalbenu komisiju za civilne službenike i javne službenike;
2.10. Lëshimi i vërtetimeve të marrëdhënies/ përvojës së punës, nxjerrja dhe përcjellja e statistikave për të punësuarit;	2.10. Issuing employment/work experience certificates, issuing and following employee statistics;	2.10. Izdavanje potvrda o radnom odnosu/radnom iskustvu, izdavanje i prenos statistike za zaposlene;
2.11. Administrimi i dosjeve të	2.11. Administration of personnel files	2.11. Upravljanje dosijeima osoblja

personelit (dosje individuale) të Zyrës së Kryeministrit bëhet përmes platformës elektronike, Sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ);	(individual files) of the Office of the Prime Minister is carried out through the electronic platform Human Resources Management System (HRMIS);	(pojedinačni dosijei) Kancelarije premijera vrši se putem elektronske platforme, Sistemom za upravljanje ljudskim resursima (SULjR);
2.12. Administrimi i pagave, kompensimet në pagë, shpërblimet, shtesat në pagë të nëpunësve;	2.12. Administration of salaries, compensations, bonuses, salary allowances of servants;	2.12. Upravljanje platama, naknadama za plate, nagradama, dodacima na plate službenika;
2.13. Përgatitja e raportit vjetor dhe planit të punës për menaxhimin e burimeve njerëzore.	2.13. Preparing the annual report and work plan for human resource management.	2.13. Priprema godišnjeg izveštaja i plana rada za upravljanje ljudskim resursima.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i raporton dhe i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm.	3. The Head of the Division for Human Resources Management shall report and respond to the Secretary General.	3. Rukovodilac odseka za upravljanje ljudskim resursima izveštava i odgovara generalnom sekretaru.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është katër (4).	4. The number of employees in the Division for Human Resources Management shall be four (4).	4. Broj zaposlenih u Odeljenju za upravljanje ljudskim resursima je četiri (4).
Neni 62 **Njësia për Auditim të Brendshëm**	**Article 62** **Internal Audit Unit**	**Član 62** **Jedinica za internu reviziju**
1. Detyrat e Njësisë për Auditim të Brendshëm në ZKM ushtrohen nga Udhëheqësi i Njësisë për Auditim të Brendshëm, në pajtim me Ligjin përkatës për kontrollin e brendshëm të financave publike.	1. The duties of the Internal Audit Unit in the OPM shall be exercised by the Head of the Internal Audit Unit, in accordance with the relevant Law on Public Internal Financial Control.	1. Dužnosti Jedinice za internu reviziju u KP vrši rukovodilac Jedinice za internu reviziju, u skladu sa odgovarajućim Zakonom o unutrašnjoj kontroli javnih finansija.

2. Njësia për Auditim të Brendshëm e ka statusin e divizionit në kuptim të nenit 21, paragrafi 4 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.	2. The Internal Audit Unit has the status of a division within the meaning of Article 21, paragraph 4 of Law no. 06 / L-113 on the Organization and Functioning of the State Administration and Independent Agencies.	2. Jedinica za unutrašnju reviziju ima status odsek u smislu člana 21. stav 4. Zakona br. 06 / L-113 o organizaciji i funkcionisanju državne uprave i nezavisnih agencija.
3. Numri i të punësuarve në Njësinë për Auditim të Brendshëm është tre (3).	3. The number of employees in the Internal Audit Unit shall be three (3).	3. Broj zaposlenih u Jedinici za internu reviziju je tri (3).
Neni 63 **Zyra e ish Kryeministrit**	**Article 63** **Office of the former Prime Minister**	**Član 63** **Kancelarija bivšeg premijera**
Është themeluar në bazë të Ligjit nr.03/L-001 Për përfitimin e ish Zyrtarëve të Lartë. Zyra drejtohet nga ish Kryeministri.	Office of the former Prime Minister shall be established pursuant to the Law No. 03/L-001 on Benefits to Former High Officials. The office shall be led by the former Prime Minister.	Osnovana je na osnovu zakona br. 03 /L-001 o prinadležnostima bivših visokih zvaničnika. Kancelarijom rukovodi bivši premijer.
KAPITULLI III **AGJENCITË EKZEKUTIVE**	**CHAPTER III** **EXECUTIVE AGENCIES**	**POGLAVLJE III** **IZVRŠNE AGENCIJE**
Neni 64 **Agjencitë ekzekutive**	**Article 64** **Executive agencies**	**Član 64** **Izvršne agencije**
1. Agjencitë ekzekutive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit janë:	1. The executive agencies within the Office of the Prime Minister shall be the following:	1. Izvršne agencije u okviru Kancelarije premijera su:
1.1. Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ);	1.1. Agency for Gender Equality (AGE);	1.1. Agencija za rodnu ravnopravnost (ARR);

1.2. Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRRSB);	1.2. Kosovo Agency on Protection from Radiation and Nuclear Safety (KAPRNS);	1.2. Agencija za zaštitu od zračenja i nuklearnu bezbednost (AZZNB);
1.3. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV);	1.3. Food and Veterinary Agency (FVA);	1.3. Agencija za hranu i veterinu (AHV);
1.4. Sekretariati i Këshillit të Sigurisë (SKS);	1.4. Security Council Secretariat (SCS);	1.4. Sekretarijat Saveta bezbednosti (SSB);
Neni 65 **Agjencia për Barazi Gjinore**	**Article 65** **Agency on Gender Equality**	**Član 65** **Agencija za rodnu ravnopravnost**
1. Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) është Agjenci Ekzekutive, e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj të përcaktuara me Ligjin përkatës për barazi gjinore dhe Rregulloren përkatëse për organizimin e Agjencisë për Barazi Gjinore.	1. The Agency for Gender Equality (AGE) is an Executive Agency acting within the Office of the Prime Minister and exercises its functions and responsibilities defined by the relevant Law on Gender Equality and the respective Regulation on the organization of the Agency on Gender Equality.	1. Agencija za rodnu ravnopravnost (ARR) je Izvršna agencija koja deluje u okviru Kancelarije premijera i izvršava svoje funkcije i odgovornosti utvrđene relevantnim Zakonom o rodnoj ravnopravnosti i relevantnom Uredbom o organizaciji Agencije za rodnu ravnopravnost.
2. ABGJ kryen detyrat dhe përgjegjësitë tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi si dhe detyrat e përcaktuara nga Kryeministri.	2. AGE shall perform other duties and responsibilities provided for by legislation in force as well as duties assigned by the Prime Minister.	2. ARR obavlja i druge dužnosti i odgovornosti utvrđene važećim zakonodavstvom, kao i dužnosti određene od premijera.
Neni 66 **Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore**	**Article 66** **Kosovo Agency on Protection from Radiation and Nuclear Safety**	**Član 66** **Agencija za zaštitu od zračenja i nuklearnu bezbednost Kosova**
1. Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore	1. Kosovo Agency on Protection from Radiation and Nuclear Safety (KAPRNS),	1. Agencija za zaštitu od zračenja i nuklearnu bezbednost Kosova

(AKMRRSB), si Agjenci ekzekutive e Qeverisë përkatësisht Zyrës së Kryeministrit, ushtron funksionet dhe përgjegjësit e saj të përcaktuara me Ligjin përkatës për mbrojtje dhe siguri bërthamore dhe Rregulloren përkatëse për organizimin e Agjencisë.	as a governmental, namely Office of the Prime Minister executive agency shall exercise its functions and responsibilities as provided for by the relevant Law on Kosovo Agency on Protection from Radiation and Nuclear Safety and respective Regulation on the organization of the Agency.	(AZZNBK), kao Izvršna agencija Vlade, odnosno Kancelarija premijera, izvršava svoje funkcije i odgovornosti utvrđene odgovarajućim Zakonom o nuklearnoj zaštiti i bezbednosti i relevantnom Uredbom o organizaciji Agencije.
2. Agjencia kryen detyrat dhe përgjegjësitë tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi si dhe detyrat e përcaktuara nga Kryeministri.	2. The Agency shall perform other duties and responsibilities as provided for by legislation in force, as well as duties assigned by the Prime Minister.	2. Agencija obavlja i druge dužnosti i odgovornosti utvrđene važećim zakonodavstvom, kao i zadatke koje je odredio premijer.
Neni 67 **Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë**	**Article 67** **Food and Veterinary Agency**	**Član 67** **Agencija za hranu i veterinu**
1. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) është Agjenci Ekzekutive, e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj të përcaktuara me Ligjin përkatës për Ushqimin dhe Rregulloren përkatëse për organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.	1. The Food and Veterinary Agency (FVA) is an executive agency acting within the Office and the Prime Minister and exercises its functions and responsibilities as provided for by the relevant Law on Food and the respective Regulation on the Organization of the Food and Veterinary Agency.	1. Agencija za hranu i veterinu (AHV) je Izvršna agencija koja deluje u okviru Kancelarije Premijera i vrši svoje funkcije i odgovornosti definisane relevantnim Zakonom o hrani i relevantnom Uredbom o organizaciji Agencije za hranu i veterinu.
2. AUV kryen detyrat dhe përgjegjësitë tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi i cili e rregullon çështjen e sigurisë së ushqimit, me prejardhje shtazore dhe bimore, çështjen e shëndetit publik, shëndetit të kafshëve dhe të mirëqenies së tyre, shëndetin e bimëve, çështjen e kontrollit zyrtar veterinar, fitosanitar dhe	2. FVA shall perform other duties and responsibilities provided for by the legislation in force, which regulates the issue of food safety of animal and plant origin, issue of public health, health of animals and their welfare, health of plants, issue of the official veterinary, phytosanitary and sanitary control and other	2. AHV obavlja i druge dužnosti i odgovornosti definisane važećim zakonodavstvom koje regulišu pitanje bezbednosti hrane, životinjskog i biljnog porekla, pitanje javnog zdravlja, zdravlja i dobrobiti životinja, zdravlja biljaka, pitanje službene veterinarske, fitosanitarne i sanitarne kontrole kao i drugim

sanitar si dhe legjislacionin tjetër përkatës si dhe detyrat e përcaktuara nga Kryeministri.	respective legislation and the duties assigned by the Prime Minister.	odgovarajućim zakonodavstvom, kao i zadacima koje je odredio premijer.
Neni 68 **Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës**	**Article 68** **Kosovo Security Council Secretariat**	**Član 68** **Sekretarijat Saveta bezbednosti Kosova**
1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka Sekretariatin e tij i cili udhëhiqet nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe i raporton drejtpërdrejtë Kryesuesit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.	1. The Kosovo Security Council has its own Secretariat which is led by the Kosovo Security Council Secretary and the same reports directly to the Chairperson of the Kosovo Security Council.	1. Savet bezbednosti Kosova ima svoj sekretarijat kojim rukovodi sekretar Saveta bezbednosti Kosova, koji direktno izveštava predsedavajućem Saveta bezbednosti Kosova.
2. Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës është përgjegjës për:	2. The Kosovo Security Council Secretariat shall be responsible for the following:	2. Sekretarijat Saveta bezbednosti Kosova je odgovoran za:
2.1. përgatitjen e raporteve periodike dhe analizave për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Këshillin e Sigurisë së Kosovës që kanë të bëjnë me çështjet politike të sigurisë;	2.1. preparing periodic reports and analyses for the Government of the Republic of Kosovo and the Kosovo Security Council with regard to the political security issues;	2.1. pripremu periodičnih izveštaja i analiza za Vladu Republike Kosovo i Savet bezbednosti Kosova o političkim pitanjima bezbednosti;
2.2. koordinimin e hartimit të strategjisë dhe politikave të sigurisë në Kosovë, përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve, instrumentet e politikave dhe hulumtimit; ofrimin e mbështetjes administrative dhe funksionale Këshillit të Sigurisë së Kosovës.	2.2. coordinating the drafting of the security strategy and policies in Kosovo, including capacity building, policy instruments and research; providing administrative and functional support to the Kosovo Security Council.	2.2. koordiniranje izrade strategije i politika bezbednosti na Kosovu, uključujući izgradnju kapaciteta, instrumente politike i istraživanja; pružanje administrativne i funkcionalne podrške Savetu bezbednosti Kosova.
3. Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës kryen detyrat dhe përgjegjësitë e	3. The Kosovo Security Council Secretariat shall perform the duties and responsibilities	3. Sekretarijat Saveta bezbednosti Kosova vrši dužnosti i odgovornosti utvrđene

përcaktuara me Ligjin përkatës për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe me Rregullore përkatëse për organizimin dhe punën e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.	defined by the relevant Law on the Establishment of the Kosovo Security Council and the relevant Regulation on the organization and work of the Kosovo Security Council Secretariat, as well as other legislation in force.	odgovarajućim Zakonom o osnivanju Saveta bezbednosti Kosova i relevantnom uredbom o organizaciji i radu Sekretarijata Saveta bezbednosti Kosova i drugim važećim zakonima.
KAPITULLI IV **STRUKTURAT E TJERA ADMINISTRATIVE**	**CHAPTER IV** **OTHER ADMINISTRATIVE STRUCTURES**	**POGLAVLJE IV** **OSTALE ADMINISTRATIVNE STRUKTURE**
Neni 69 **Strukturat e tjera administrative që veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në bazë të ligjeve të veçanta**	**Article 69** **Other administrative structures operating within the Office of the Prime Minister based on special laws**	**Član 69** **Ostale administrativne strukture koje deluju u okviru Kancelarije premijera na osnovu posebnih zakona**
1. Në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, bëjnë pjesë edhe strukturat administrative të përcaktuara me ligje dhe akte përkatëse nënligjore të veçanta, si në vijim:	1. Within the Office of the Prime Minister, there are also administrative structures defined by laws and relevant special sub-legal acts, as follows:	1. U okviru Kancelarije premijera postoje i sledeće administrativne strukture utvrđene zakonima i odgovarajućim posebnim podzakonskim aktima:
1.1 Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur (KQPZH);	1.1. Government Commission on Missing Persons (GCMP);	1.1 Vladina komisija za nestala lica (VKNL);
1.2. Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ);	1.2. Office of the Language Commissioner (OLC);	1.2. Kancelarija Poverenika za jezike (KPJ);
1.3. Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA);	1.3. Commission for the Investigation of Aeronautical Accidents and Incidents (CIAAI);	1.3. Komisija za istraživanje vazduhoplovnih udesa i incidenata (KIVUI);

Neni 70 Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur	Article 70 Government Commission on Missing Persons	Član 70 Vladina komisija za nestala lica
1. Përbërja, përgjegjësitë, fushëveprimi, rregullat dhe procedurat e punës të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur janë të përcaktuara me ligjin përkatës për persona të zhdukur, dhe me rregulloren përkatëse për punën e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur.	1. The composition, responsibilities, scope, rules and working procedures of the Government Commission on Missing Persons are defined by the relevant law on missing persons, and the relevant regulations for the work of the Government Commission on Missing Persons.	1. Sastav, odgovornosti, delokrug, pravila i procedure rada Vladine komisije za nestala lica utvrđeni su odgovarajućim zakonom o nestalim licima i odgovarajućom uredbom o radu Vladine komisije za nestala lica.
2. Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi emërohen nga Kryeministri, në pajtim me ligjin përkatës për persona të zhdukur.	2. The chairperson and deputy chairperson are appointed by the Prime Minister, in accordance with the relevant Law on missing persons.	2. Predsedavajućeg i zamenika predsedavajućeg imenuje Premijer, u skladu sa odgovarajućim zakonom o nestalim licima..
3. Në kuadër të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur funksionon Divizioni për mbështetjen e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, i cili shërben për të organizuar, bashkërenduar, zhvilluar dhe mirëmbajtur aktivitetet e nevojshme për punën e Komisionit.	3. Within the Government Commission on Missing Persons, there is a Division for the support of the Government Commission on Missing Persons, which serves to organize, coordinate, develop and maintain the activities necessary for the work of the Commission.	3. U okviru Vladine komisije za nestala lica deluje Odsek za podršku Vladinoj komisiji za nestala lica koja služi za organizovanje, koordinaciju, razvoj i održavanje aktivnosti neophodnih za rad Komisije.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për mbështetjen e KQPZH-së është katër (4).	4. The number of employees in the Division for Support of the GCMP shall be four (4).	4. Broj zaposlenih u Odseku za podršku VKNL je četiri (4).

Neni 71 **Zyra e Komisionerit për Gjuhët**	**Article 71** **Office of the Language Commissioner**	**Član 71** **Kancelarija poverenika za jezike**
1. Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit nën udhëheqjen e Komisionerit për Gjuhët, i cili është përgjegjës për menaxhimin e Zyrës dhe ushtrimin e kompetencave të saj në pajtim me Rregulloren përkatëse për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët.	1. The Office of the Language Commissioner (OLC) shall operate within the Office of the Prime Minister under the leadership of the Language Commissioner, who shall be responsible for managing the Office and exercising its competencies in accordance with the relevant Regulation of the Office of the Language Commissioner.	1. Kancelarija poverenika za jezike (KPJ) deluje u okviru Kancelarije Premijera pod rukovodstvom poverenika za jezike, koji je odgovoran za upravljanje Kancelarijom i vršenje svojih ovlašćenja u skladu sa relevantnom Uredbom o Kancelariji poverenika za jezike.
2. Numri i të punësuarve në ZKGJ është shtatë (7).	2. The number of employees in the OLC shall be seven (7).	2. Broj zaposlenih u KPJ je sedam (7).
Neni 72 **Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike**	**Article 72** **Commission for the Investigation of Aeronautical Accidents and Incidents**	**Član 72** **Komisija za istraživanje vazduhoplovnih udesa i incidenata**
1. Përgjegjësitë, fushëveprimi, rregullat dhe procedurat e punës të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA) janë të përcaktuara me ligjin përkatës për aviacionin civil.	1. The responsibilities, scope, rules and procedures of the Commission for the Investigation of Aeronautical Accidents and Incidents (CIAAI) shall be defined by the relevant law on civil aviation.	1. Odgovornosti, delokrug, pravila i radni postupci Komisije za istraživanje vazduhoplovnih udesa i incidenata (KIVUI) utvrđeni su odgovarajućim zakonom o civilnom vazduhoplovstvu.
2. Përbërja e KHAIA-së është si në vijim:	2. The composition of CIAAI shall be as follows:	2. Sastav KIVUI je sledeći:
2.1. Kryesues i KHAIA- hetues i aksidenteve dhe incidenteve;	2.1. Head of CIAAI - accident and incident investigator;	2.1. Predsedavajući KIVUI- istražitelj udesa i incidenata;
2.2. Dy (2) anëtarë të KHAIA-së – hetues i aksidenteve dhe incidenteve	2.2. Two (2) members of CIAAI - investigator of aeronautical accidents and	2.2. Dva (2) člana KIVUI - istražitelj vazduhoplovnih udesa i incidenata;

aeronautike; 2.3. Një (1) anëtar i KHAIA-së - hetues i aksidenteve hekurudhore. 3. Për ofrimin e mbështetjes profesionale dhe administrative, në kuadër të KHAIA-së, janë të punësuar tre (3) nëpunës civil: 3.1. Dy (2) nëpunës civilë profesional; 3.2. Një (1) nëpunës administrativ mbështetës.	incidents; 2.3. One (1) member of CIAAI - Railway Accident Investigator. 3. To provide professional and administrative support, within the CIAAI, three (3) civil servants shall be employed: 3.1. Two (2) professional civil servants; 3.2. One (1) administrative support officer.	2.3. Jedan (1) član KIVUI - istražitelj železničkih nesreća. 3. Za pružanje profesionalne i administrativne podrške, u okviru KIVUI-a je zaposleno troje (3) civilnih službenika: 3.1. Dva (2) profesionalna civilna službenika; 3.2. Jedan (1) službenik administrativne podrške.
KAPITULLI IV **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**	**CHAPTER IV** **TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS**	**POGLAVLJE IV** **PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE**
Neni 73 **Strukturat e përkohshme**	**Article 73** **Temporary structures**	**Član 73** **Privremene strukture**
1. Me vendim të Qeverisë mund të themelohen struktura të përkohshme të cilat kanë për qëllim adresimin e nevojave dhe prioriteteve të caktuara të Qeverisë. 2. Strukturat nga paragrafi 1 i këtij neni nuk janë pjesë e strukturës së rregullt organizative të ZKM-së të përcaktuar me këtë rregullore.	1. By a decision of the Government, temporary structures may be established, which aim at addressing certain needs and priorities of the Government. 2. The structures from paragraph 1 of this Article are not part of the regular organizational structure of the OPM defined by this regulation.	1. Odlukom Vlade mogu se uspostaviti privremene strukture čiji je cilj adresiranje određenih potreba i prioriteta Vlade. 2. Strukture iz stava 1. ovog člana nisu deo redovne organizacione strukture KP utvrđene ovom uredbom.

Neni 74 **Ndarja e përgjegjësive brenda zyrës në rast të mbingarkesës**	**Article 74** **The division of responsibilities within the office in case of overload**	**Član 74** **Podela odgovornosti u kancelariji u slučaju preopterećenja**
Pavarësisht nga ndarjet e punëve sipas përshkrimit të detyrave për divizionet, drejtori i zyrës në rast të mbingarkesës me punë të njërit divizion, mund të shpërndajë detyrat te divizionet e tjera brenda zyrës.	Regardless of the division of works according to the job description for the divisions, the Director of Office, in case of work overload of one division, may distribute the tasks to the other divisions within the office.	Bez obzira na podelu rada prema opisu posla za odseke, direktor kancelarije u slučaju preopterećenja radom jednog odseka, može rasporediti zadatke ostalim odsecima u kancelariji.
Neni 75 **Interpretimi**	**Article 75** **Interpretation**	**Član 75** **Tumačenje**
Zyra Ligjore në ZKM është përgjegjëse për lëshimin e opinioneve juridike për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje.	The Legal Office in the OPM shall be responsible for issuing legal opinions for enforcement of provisions of this Regulation.	Pravna kancelarija u KP je odgovorna za izdavanje pravnih mišljenja o primeni odredaba ove uredbe.
Neni 76 **Statusi tranzitor i Zyrës për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Zyrës për Çështje të Komuniteteve**	**Article 76** **Transitional status of the Office for Issues of Categories Deriving from the War of the Kosovo Liberation Army and the Office for Community Affairs**	**Član 76** **Prelazni status Kancelarija za pitanja kategorija proizašlih iz rata Oslobodilačke vojske Kosova i Kancelarija za pitanja zajednica**
Udhëheqësit aktual të pozitave të përcaktuara me dispozitat e nenit 45, paragrafi 6 dhe nenit 48, paragrafit 4 të kësaj rregulloreje vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre deri në përzgjedhjen e udhëheqësve në pajtim me legjislacionin përkatës për zyrtarët publikë dhe	The current heads of the positions defined by the provisions of Article 45, paragraph 6 and Article 48, paragraph 4 of this Regulation shall continue to exercise their functions until the selection of leaders in accordance with the relevant legislation on public officials and the Government.	Trenutni rukovodioci pozicija definisanih odredbama člana 45. stav 6. i člana 48. stav 4. ove uredbe nastavljaju da vrše svoje funkcije do izbora rukovodilaca u skladu sa relevantnim zakonodavstvom o javnim službenicima i Vladi.

Qeverinë. **Neni 77** **Shfuqizimi** Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Nr. 16/2013 për Strukturën Organizative në Zyrën e Kryeministrit, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 08/2016, me Rregulloren Nr. 11/2016, me Rregulloren Nr. 02/2017, me Rregulloren Nr. 02/2019 si dhe Rregullorja Nr. 32/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Integrimit Evropian e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 27/2013 dhe me Rregulloren Nr. 08/2019. **Neni 78** **Hyrja në fuqi** Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. **Avdullah HOTI** _____ Kryeministër i Republikës së Kosovës Datë 16 /11/2020	**Article 77** **Repeal** Upon the entry into force of this Regulation, the Regulation No. 16/2013 on the Organizational Structure in the Office of the Prime Minister, amended and supplemented by Regulation No. 08/2016, with Regulation No. 11/2016, with Regulation No. 02/2017, with Regulation No. 02/2019 and Regulation No. 32/2012 on Internal Organization and Systematization of Jobs in the Ministry of European Integration, amended and supplemented by Regulation No. 27/2013 and Regulation No. 08/2019, shall be repealed. **Article 78** **Entry into force** This Regulation shall enter into force seven (7) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo. **Avdullah HOTI** _____ Prime Minister of the Republic of Kosovo Date 16 /11/2020	**Član 77** **Ukidanje** Stupanjem na snagu ove Uredbe, ukida se Uredba br. 16/2013 o organizacionoj strukturi u Kancelariji premijera, izmenjena i dopunjena Uredbom br. 08/2016, Uredbom br. 11/2016, Uredbom br. 02/2017, Uredbom br. 02/2019 kao i Uredbom br. 32/2012 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u Ministarstvu za evropske integracije, izmenjena i dopunjena Uredbom br. 27/2013 o Uredbom br. 08/2019. **Član 78** **Stupanje na snagu** Ova Uredba stupa na snagu sedam (7) dana od objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo. **Avdullah HOTI** _____ Premijer Republike Kosovo Datum 16 /11/2020


Kabineti i Kryeministrit
Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur
Zyra e Komisionerit për Gjuhët
Komisioni për Hetimin e Aksidenteve Aeronautike
Njësia e Auditimit të Brendshëm
Agjencia për Barazi Gjinore
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
Agjencia për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore
Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
Zyra për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme
Zyra për Buxhet dhe Financa
Divizioni për Prokurim Publik
Divizioni për Komunikim dhe Informim
Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Divizioni për Teknologji Informative
Divizioni për Logjistikë
Divizioni për Përkthime
Divizioni për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv
Divizioni për Buxhet
Divizioni për Financa
Zyra Ligjore
Zyra për Planifikim Strategjik
Sekretariati Mbështetës i Qeverisës
Zyra për Qeverisje të Mirë të dhe të Drejtat e Nieriut
Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare
Zyra për Koordinimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit
Zyra për Kriteret Politike
Zyra për Kritere Ekonomike dhe Treg të Brendshëm
Zyra për Politika Sektoriale
Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim
Zyra për Çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta e UÇK
Zyra për Çështje të Komuniteteve
Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit
Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të
Divizioni për Zvogëlimin e Barrës Administrative nëpërmjet Thjeshtimit të Lejeve dhe Licencave
Divizioni për të Drejtën e BE
Divizioni për Planifikim
Divizioni për Monitorim dhe Vlerësim
Divizioni për Analiza të Politikave
Divizioni për Mbledhje të Qeverisë dhe Koordinim me Kuvendin
Divizioni për Mbështetje të Komisioneve për Rekrutimin e Drejtorëve të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike
Divizioni për Qeverisje të Mirë
Divizioni për të Drejtat e Njeriut
Divizioni për Pranim, Korrektim dhe Redaktim Teknik të Gazetës Zyrtare
Divizioni për Botim, Publikim dhe Mirëmbajtje të Sistemit Elektronik të Gazetës Zyrtare
Divizioni për Konsolidimin e Akteve Juridike
Divizioni për Koordinim Horizontal të Procesit të Stabilizim-Asociimit
Divizioni për Koordinim Institucional
Divizioni për Kritere Politike dhe Administrative
Divizioni për Gjyqësorin dhe të Drejtat Themelore
Divizioni për Drejtësi, Liri dhe Siguri
Divizioni për Ekonomi, Zhvillim Rajonal dhe Statistika
Divizioni për Treg të Brendshëm dhe Tregti
Divizioni për Politika Sociale, Arsim dhe Shëndetësi
Divizioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Siguri të Ushqimit
Divizioni për Mjedis, Energji dhe Transport
Divizioni për Monitorim dhe Raportim
Divizioni për Administratën Publike dhe Sundimin e Ligjit
Divizioni për Zhvillim Ekonomik dhe Social
Divizioni për Veteranët e Luftës së UÇK
Divizioni për Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidët e Luftës së UÇK
Divizioni për Politika të Komuniteteve
Divizioni për Koordinim dhe Monitorim të Granteve dhe Subvencioneve


Cabinet of the Prime Minister
Government Commission on Missing Persons
Office of the Language Commissioner
Commission for the Investigation of Aeronautical Accidents
Internal Audit Unit
Agency for Gender Equality
Food and Veterinary Agency
Agency on Protection from Radiation and Nuclear Safety
Kosovo Security Council Secretariat
Office of the Secretary General
Office of Administration and General Services
Division for Information Technology
Division for Logistics
Division for Translation
Division for Administration of Documents and Archive
Office of Budget and Finance
Division for Budget
Division for Finances
Division for Public Procurement
Division for Communication and Information
Division for Human Resource Management
Legal Office
Division for Drafting and Harmonization of Legislation
Division for Monitoring the Implementation of Legislation, Legal
Division for Reduction of Administrative Burden by Simplifying Permits and Licences
Division for EU Law
Strategic Planning Office
Division for Planning
Division for Monitoring and Evaluation
Division for Policy Analyses
Government Supporting Secretariat
Division for Organization of Government Meetings and Coordination with the Assembly
Division for Supporting Commissions for Recruitment of Directors of Publicly-Owned Enterprises
Office for Good Governance and Human Rights
Division for Good Governance
Division for Human Rights
Office for Publication of Official Gazette
Division for Receiving, Correcting and Technical Editing of the Official Gazette
Division for Issuance, Publication and Maintenance of Official Gazette Electronic System
Division for Consolidation of Legal Acts
Office for Coordination of Stabilisation and Association Process
Division for Horizontal Coordination of the Stabilisation and Association Process
Division for Institutional Coordination
Office for Political Criteria
Division for Political and Administrative Criteria
Division for Judiciary and Fundamental Rights
Division for Justice, Freedom and Security
Office for Economic Criteria and Internal Market
Division for Economy, Regional Development and Statistics
Division for Internal Market and Trade
Division for Social Policies, Education and Health
Office for Sector Policies
Division for Agriculture, Forestry, Rural Development and Food Safety
Division for Environment, Energy and Transport
Development Cooperation Office
Division for Monitoring and Reporting
Division for Public Administration and Rule of Law
Division for Economic and Social Development
Office for Issues of Categories Deriving from the War of the KLA
Division for KLA War Veterans
Division for Families of Martyrs and KLA War Invalids
Office for Community Affairs
Division for Community Policies
Division for Coordination and Monitoring of Grants and Subsidies


Kabinet premijera
Komisija Vlade za nestala lica
Kancelarija poverenika za jezike
Komisija za istraživanje vazduhoplovnih nesreća
Jedinica za internu reviziju
Agencija za rodnu ravnopravnost
Agencija za hranu i veterinu
Agencija za zaštitu od zračenja i nuklearnu sigurnost
Sekretarijat Saveta bezbednosti Kosova
Kancelarija generalnog sekretara
Kancelarija za administrativne i opšte usluge
Odsek za informativnu tehnologiju
Odsek za logistiku
Odsek za prevođenje
Odsek za administraciju dokumenata i arhiv
Kancelarija za budžet i finansije
Odsek za budžet
Odsek za finansije
Odsek za javnu nabavku
Odsek za komunikacij u i informisanje
Odsek za upravljanje ljudskim resursima
Pravna kancelarija
Odsek za izradu i usklađivanje zakonodavstva
Odsek za praćenje primene zakonodavstva, pravne podrške i
Odsek za smanjenje administrativnog opterećenja pojednostavljivanjem dozvola i licenci
Odsek za pravo EU
Kancelarija za strateško planiranje
Odsek za planiranje
Odsek za praćenje i evaluaciju
Odsek za analize politika
Sekretarijat Vlade za podršku
Odsek za organizaciju sastanaka Vlade i koordinaciju sa Skupštinom
Odsek za podršku komisijama za zapošljavanje direktora javnih preduzeća
Kancelarija za dobro upravljanje i ljudska prava
Odsek za dobro upravljanje
Odsek za ljudska prava
Kancelarija za objavljivanje službenog lista
Odsek za prijem, ispravljanje i tehničko uređivanje Službenog lista
Odsek za izdavanje, objavljivanje i održavanje elektronskog sistema Službenog lista
Odsek za konsolidaciju pravnih akata
Kancelarija za koordinaciju procesa stabilizacije i pridruživanja
Odsek za horizontalnu koordinaciju procesa stabilizacije i pridruživanja
Odsek za institucionalnu koordinaciju
Kancelarija za političke kriterijume
Odsek za političke i administrativne kriterijume
Odsek za pravosuđe i osnovna prava
Odsek za pravdu, slobodu i bezbednost
Kancelarija za ekonomske kriterijume i unutrašnje tržište
Odsek za ekonomiju, regionalni razvoj i statistiku
Odsek za unutrašnje tržište i trgovinu
Odsek za socijalnu politiku, obrazovanje i zdravstvo
Kancelarija za sektorske politike
Odsek za poljoprivredu, šumarstvo, ruralni razvoj i sigurnost hrane
Odsek za zaštitu životne sredine, energetiku i transport
Kancelarija za razvojnu saradnju
Odsek za praćenje i izveštavanje
Odsek za javnu upravu i vladavinu prava
Odsek za ekonomski i socijalni razvoj
Kancelarija za pitanja kategorija proisteklih iz rata OVK
Odsek za ratne veterane OVK
Odsek za porodice mučenika i ratne vojne invalide OVK
Kancelarija za pitanja zajednica
Odsek za politike zajednice
Odsek za koordinaciju i nadgledanje grantova i subvencija